

URDHËR
Nr. 125, datë 30.7.2025

**PËR MIRATIMIN DHE PUBLIKIMIN E PROFILIT VJETOR KOMBËTAR TË
MIGRACIONIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, PËR VITIN 2024**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 138, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Profilit Vjetor Kombëtar të Migracionit në Republikën e Shqipërisë, për vitin 2024, sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Drejtoria e Monitorimit dhe Jetësimit të Prioriteteve në Ministrinë e Brendshme dhe Sektori i Komunikimit me Median në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit të publikojnë në faqet zyrtare të internetit Profilin Vjetor Kombëtar të Migracionit për vitin 2024 në Republikën e Shqipërisë.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Ervin Hoxha

ANEKS 1

PROFILI VJETOR KOMBËTAR I MIGRACIONIT PËR VITIN 2024
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Tiranë 2025

Profili Vjetor Kombëtar i Migracionit të Shqipërisë (2024) është i pesti i zhvilluar nga Ministria e Brendshme, duke u bazuar në përvojat e mëparshme në hartimin e profileve vjetore të migracionit. Dokumenti është hartuar mbështetur në nenin 138, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”.

Ky dokument vazhdon praktikën e mira të paraqitjes së të dhënave migratore, që janë reflektuar edhe në profilet vjetore kombëtare në të kaluarën. Dokumenti përfshin disa drejtime tematike kryesore që kanë rëndësi specifike për Shqipërinë, si dhe sjell praktikën pozitive që përdoren nga Rrjeti Evropian i Migracionit (EMN) për raportet e tyre vjetore mbi Migracionin dhe Azilin.

Migracioni në kontekstin e Shqipërisë është një fenomen që në 35 vitet e fundit është shfaqur me një shumëllojshmëri elementesh, efekti social i të cilave ndjehet shumë shpejt, si në këndvështrimin pozitiv ashtu dhe atë negativ.

Përmes mbledhjes dhe analizës së të dhënave dhe statistikave zyrtare, qëllimi kryesor i Profilit është të ofrojë, në një gjuhë të kuptueshme për grupe interesi të ndryshme, informacion të përditësuar mbi tendencat kryesore të migracionit, duke mbështetur kështu punën e studiuesve dhe përfaqësuesve të akademisë të interesuar në këtë fushë.

Profili, nëpërmjet analizave dhe të dhënave të paraqitura, synon trajtimin sa më efektiv të sfidave të migracionit në nivel kombëtar, si dhe vjen si një mjet që do të ndihmojë në hartimin e politikave afatshkurtra dhe afatmesme për mirëqeverisjen e migracionit.

Gjithashtu, profili vjetor shërben si një burim të dhënash administrative dhe referencash dytësore për lëvizjet migratore. Konkretisht, ky raport paraqet dinamikat migratore në kontekstin shqiptar për vitin 2024, krahasuar me vitet e mëparshme.

Pjesa narrative e profilit është konceptuar në një kontekst gjithëpërfshirës, si dhe përshkruan masat kryesore të ndërmarra në fushën e politikës së migracionit në vend gjatë vitit 2024, në nivel ligjor, politikash dhe praktikash. Përpos trajtimit të çështjeve të përgjithshme të menaxhimit të migracionit, ajo mbulon disa drejtime tematike që paraqiten në seksionin e statistikave.

Ashtu si profilet e viteve të kaluara, edhe ky dokument mbështetet në të dhënat zyrtare të Institutit Kombëtar të Statistikave të Shqipërisë (INSTAT), Ministrisë së Brendshme, Zyrës Statistikore të Bashkimit Evropian (EUROSTAT), Agjencive të Kombeve të Bashkuara, si dhe të dhëna administrative të autoriteteve shtetërore shqiptare.

Profilu Vjetor Kombëtar i Migracionit, i miratuar me urdhër të ministrit të Brendshëm gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme, si dhe i botuar në Fletoren Zyrtare.

Tabela e përmbajtjes

1. Akronimet dhe shkurtesat
2. Informacion i përgjithshëm mbi vendin
 - 2.1 Sipërfaqja, popullsia, vendet kufitare dhe vija kufitare
 - 2.2 Kuadri institucional për menaxhimin e migracionit në Shqipëri
 - 2.3 Konteksti kombëtar
3. Flukset e përgjithshme migratore
 - 3.1 Flukset migratore
4. Migracioni i rregullt i fokusuar në migracionin për punësim
 - 4.1 Autoritetet përgjegjëse shtetërore
 - 4.2 Kuadri ligjor
 - 4.3 Statistikat
5. Migracioni i parregullt në vend
 - 5.1 Autoritetet përgjegjëse
 - 5.2 Kuadri ligjor
 - 5.3 Menaxhimi i migracionit të parregullt
 - 5.4 Statistikat
6. Kthimi, ripranimi dhe riintegrimi
 - 6.1 Autoritetet përgjegjëse
 - 6.2 Kuadri ligjor
 - 6.3 Statistika
7. Integrimi
 - 7.1 Autoritetet përgjegjëse
 - 7.2 Kuadri ligjor
 - 7.3 Statistika
8. Migracioni dhe zhvillimi
 - 8.1 Autoritetet përgjegjëse
 - 8.2 Kuadri ligjor
9. Azili dhe mbrojtja ndërkombëtare
 - 9.1 Autoritetet përgjegjëse
 - 9.2 Statistika

1. AKRONIMET DHE SHKURTESAT

MB	Ministria e Brendshme
INSTAT	Instituti i Statistikave
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
AKPA	Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi
DKM	Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
BE	Bashkimi Evropian
EUAA	Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
KVA	Kthimi Vullnetar i Asistuar
SKM	Strategjia Kombëtare për Migracionin
OJF	Organizatë jofitimprurëse
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
SHVT	Shtetasit e vendeve të treta
MMPSH	Migrantët e mitur të pashoqëruar
UNHCR	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
VeT	Viktimë e Trafikimit
VeMT	Viktimë e Mundshme e Trafikimit
BP	Ballkani Perëndimor
FRONTEX	Agjencia Evropiane për Kufirin dhe Rojën Bregdetare

2. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI VENDIN

2.1 Sipërfaqja, popullsia, vendet kufitare dhe vija kufitare



Emërtimi Zyrtar	Shqipëria
Kryeqyteti	Tirana
Sipërfaqja	28,748 km ²
Popullsia	4,560,266 banorë (regjistruar sipas Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile). 2,402,113 banorë (popullsia banuese në Shqipëri, sipas Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023).
Gjuha	Gjuha zyrtare në Shqipëri është gjuha shqipe. Në territoret e banuara nga minoritetet, përveç gjuhës shqipe, flitet dhe gjuha greke, serbo-kroate dhe maqedonase.

Kufiri dhe shtete kufitare:

Gjatësia e përgjithshme: **1,079 km** (tokësor: 717 km; detar: 362 km);
Shtetet kufitare: Mali i Zi 151 km, Kosova 112 km, Maqedonia e Veriut 172 km, Greqia 282 km.

2.2 Kuadri institucional për menaxhimin e migracionit në Shqipëri

Institucioni lider për migracionin në nivel kombëtar

Ministria e Brendshme

- ➔ Menaxhimi i migracionit;
- ➔ Ndjekja e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin;
- ➔ Pajisja me leje qëndrimi dhe leje unike e të huajve;
- ➔ Ndalimi i migrantëve të parregullt;
- ➔ Kthimi dhe ripranimi;
- ➔ Integrimi i të huajve;
- ➔ Menaxhimi i Integruar i Kufirit;
- ➔ Lufta kundër Krimit të Organizuar Transnacional;
- ➔ Menaxhimi i Azilit;
- ➔ Lufta Kundër Trafikimit të Personave.



Institucionet kryesore përgjegjëse

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

- ➔ Migracioni për motive punësimi;
- ➔ Riintegrimi i emigrantëve të kthyer;
- ➔ Investimet e huaja;
- ➔ Analiza e tregut të punës.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

- ➔ Shërbimet konsullore;
- ➔ Çështjet e vizave;
- ➔ Marrëdhëniet me diasporën;
- ➔ Komunikimi strategjik;
- ➔ Politika e integrimit në BE.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

- ➔ Ofron shërbime shëndetësore dhe sociale për kategoritë vulnerabël të popullsisë, përfshirë migrantët.



Institucionet mbështetëse

Instituti Kombëtar i Statistikave

- ➔ Statistikat e migracionit;
- ➔ Censi i popullsisë dhe banesave;
- ➔ Anketat pranë Njësive Ekonomike Familjare (NjEF).

Ministria e Arsimit dhe Sportit

- ➔ Ndërkombëtarizimi i arsimit dhe shkencës;
- ➔ Lëvizshmëria e studentëve;
- ➔ Zhvillimi i aftësive;

2.3 Konteksti kombëtar

Shqipëria është Republikë Parlamentare, me tri degët e pavarura të qeverisjes – legjislativi (Parlamenti), ekzekutivi (qeveria) dhe gjyqësori (gjykatat). Shqipëria ka një ndarje territoriale në 12 qarqe, me kryeqytet Tiranën.

Politika migratore shqiptare është e shprehur në Kushtetutë, si korniza garantuese e të drejtave dhe lirive të të huajve, e rregulluar me anë të legjislacionit në fuqi. Institucionet përgjegjëse për trajtimin e aspekteve të ndryshme të migracionit në Republikën e Shqipërisë janë përgjegjëse për zbatimin e politikave të veçanta migratore, sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore, me anë të të cilave është rregulluar politika migratore në Republikën e Shqipërisë.

Synimi kryesor i Shqipërisë është anëtarësimi në Bashkimin Evropian, për këtë qëllim kuadri ligjor dhe strategjik për migracionin ka synuar ndërtimin e një kornize të politikave migratore, në përputhje me politikën e re të BE-së për migracionin dhe azilin, si dhe zhvillimin e partneriteteve në menaxhimin global të migracionit.

Migracioni si një fenomen global, evropian, rajonal dhe kombëtar, përbën një aspekt të rëndësishëm të marrëdhënieve të Republikës së Shqipërisë me vendet fqinje, vendet anëtare të Bashkimit Evropian e më gjerë, si dhe një sfidë tepër angazhuese në kuadër të përpjekjeve të Shqipërisë për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian.

Përgjithësisht, Shqipëria vazhdon të konsiderohet si një vend origjine i emigrantëve ekonomikë, vend tranzit dhe destinacioni për imigrantët ekonomikë, azilkërkuesit dhe refugjatët. Migracioni në kontekstin shqiptar vazhdon të karakterizohet më shumë nga emigracioni ndërkombëtar i popullsisë vendase dhe më pak nga imigracioni i të huajve në vend. Me fillimin e mijëvjeçarit të ri, modelet e migracionit dhe qëndrimi i shqiptarëve ndaj tij kanë ndryshuar për shkak të politikave shtrënguese të vendeve pritëse, veçanërisht që nga viti 2015. Shqipëria ka intensifikuar luftën kundër migracionit të parregullt, pas përballjes me flukset periodike të emigrantëve të larguar nga zonat e konfliktit.

Migrimi ndërkombëtar ka qenë një faktor ndikues në ndryshimin dhe dinamikën e popullsisë gjatë tri dekadave të fundit. Ndër arsyt kryesore, përpos zvogëlimit të shtesës natyrore, edhe migracioni mbetet një nga faktorët ndikues të rënies së popullsisë.

Sipas të dhënave të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, popullsia banuese në Shqipëri është regjistruar në 2,402,113 banorë. Numri i të huajve që qëndrojnë në territorin shqiptar arriti në 21,940 individë. Kjo përfaqëson një rritje krahasuar me vitet e mëparshme, duke reflektuar dinamika të reja migratore, përfshirë qëllime pune, studimi apo bashkim familjar.

Kur krahasohet me numrin total të banorëve, të huajt përbëjnë rreth 0.91% të popullsisë rezidente në Shqipëri. Edhe pse kjo përqindje mbetet modeste në krahasim me vendet e Bashkimit Evropian, rritja e qëndrimit të shtetasve të huaj pasqyron një hapje të tregut shqiptar të punës dhe thekson nevojën për politika të qëndrueshme integrimi dhe menaxhimi të migracionit.

Ky zhvillim meriton vëmendje të veçantë në hartimin e politikave publike, për të siguruar qasje të barabartë në shërbime dhe për të lehtësuar përfshirjen e të huajve në jetën sociale dhe ekonomike të vendit.

Ndërkohë që gjatë periudhës 2018–2022, vlerësohet se rreth 194,900 shtetas shqiptarë emigruan nga Shqipëria. Vlerësimet e emigracionit për vitin 2022 sipas përlogaritjeve rezultuan me 46,460 emigrantë të larguar¹.

¹ Burimi: INSTAT-i, <https://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/migrimi-dhe-integrimi-i-migrant%C3%ABve/#tab2>.

Të dhënat për migracionin ndërkombëtar, në nivel kombëtar përbëjnë një hallkë të rëndësishme të demografisë së vendit. Ato paraqesin të dhëna mbi ndryshimet në popullsi, të cilat kanë impakt në jetën ekonomike dhe sociale të vendit. Lëvizjet e njerëzve që hyjnë dhe dalin nga vendi janë komponenti më i vështirë për t'u matur, duke qenë se Shqipëria nuk ka ende një regjistër popullsie për qëllime statistikore. INSTAT-i vlerëson numrin vjetor të imigrantëve dhe emigrantëve bazuar në Modulën e Integruar të Migracionit, në Anketën e Forcave të Punës, që prej vitit 2015².

Komunitetet shqiptare jashtë vendit aktualisht përbëhen nga pesë grupe kryesore:

- Emigrantët ekonomikë;
- Pjesëtarët e familjeve të emigrantëve ekonomikë;
- Studentët;
- Azilkërkuesit dhe refugjatët;
- Të miturit e pashoqëruar.

Grupet më të mëdha të këtij komuniteti përbëhen nga emigrantët ekonomikë, pjesëtarët e familjeve të emigrantëve ekonomikë dhe studentët.

Menaxhimi i migracionit trajtohet me një seksion të veçantë në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHIE). SKZHIE-ja vëren së pavarësisht progresit në menaxhimin me efektivitet të migracionit në Shqipëri, disa sfida mbeten ende për t'u adresuar, si p.sh.:

i. Parandalimi i migracionit të parregullt nga vendi dhe keqpërdorimi i regjimit pa viza, në zonën *Schengen* të BE-së;

ii. Kthimi i qëndrueshëm i shqiptarëve, përmes ofrimit të mbështetjes për riintegrim;

iii. Ndikimi i zhvillimit të migracionit duhet të forcohet, ndër të tjera me anë të promovimit të investimeve njerëzore dhe financiare të shqiptarëve që janë jashtë vendit për vendin;

iv. Forcimi i strukturave të menaxhimit të migracionit dhe politikave paraprake të imigracionit dhe zbatimi i tyre bazuar në fakte solide dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë sigurimin e të drejtave të njeriut të të gjithë emigrantëve.

Vizioni i SKZHIE-së konsiston në krijimin e një sistemi efektiv të qeverisjes së migracionit në Shqipëri, përmes realizimit të objektivave të mëposhtëm strategjikë:

- Nxitja e kanaleve të sigurta dhe të rregullta për migrimin në Shqipëri, me qëllim parandalimin e migracionit të parregullt, për të kanalizuar 70% të migrimit nga Shqipëria nëpërmjet marrëveshjeve të rregullta bilaterale;

- Rritja e ndikimit të zhvillimit të emigrimit, duke krijuar mekanizma të favorshëm ligjorë dhe institucional;

- Rritja e qëndrueshmërinë së migracionit të kthimit me mbështetjen e riintegrit të emigrantëve të kthyer;

- Zbatimi i avancuar i politikave të migracionit, në mënyrë që të sigurojë trajtimin e barabartë të shtetasve të vendeve të tjera dhe integrimin e tyre në Shqipëri, në përputhje me standardet ndërkombëtare;

- Konsolidimi i politikës së migracionit, kuadrit ligjor, strukturave të menaxhimit dhe koordinimit, në mënyrë që të sigurohet reagim më i mirë ndaj sfidave të migracionit.

Më 2 maj 2024, me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 271, u miratua Strategjia e re Kombëtare për Migracionin (SKM) 2024–2030 dhe Plani i saj i Veprimit 2024–2026, e cila përmbush një nga detyrimet bazë të procesit të integrit, duke forcuar kornizën e qeverisjes së migracionit dhe azilit në vend, në bashkëpunim me të gjithë aktorët kombëtarë.

Objektivi kryesor strategjik u përcaktua të jetë: “Qeverisja e efektshme e migracionit në Shqipëri, nëpërmjet adresimit dhe menaxhimit të problematikave dhe sfidave që lindin nga lëvizjet migratore,

² Burimi: Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023

<https://www.instat.gov.al/media/14303/cens-2023.pdf>.

duke synuar rritjen e ndikimit të migracionit tek zhvillimi, në të mirë të migrantëve dhe shoqërisë shqiptare”.

Qeveria shqiptare ka vendosur të arrijë objektivin kryesor strategjik, duke u përqendruar në katër qëllimet kryesore politike, si më poshtë:

- Garantimi i qeverisjes strategjike të migracionit në Shqipëri;
- Zhvillimi i politikave të efektshme për migracionin për motive punësimi, duke rritur ndikimin pozitiv të migracionit te zhvillimi socio-ekonomik kombëtar/lokal;
- Promovimi i migracionit të rregullt, mbrojtja e të drejtave të migrantëve dhe integrimi i tyre në shoqërinë shqiptare;
- Forcimi i sistemit të mbrojtjes ndërkombëtare, garantimi i të drejtave të azilkërkuesve dhe refugjatëve, dhe ofrimi i zgjidhjeve të qëndrueshme.

3. FLUKSET E PËRGJITHSHME MIGRATORE

3.1 Flukset migratore

Popullsia e Shqipërisë nisi të zvogëlohet që prej vitit 1990, i cili shënoi një fazë të re në zhvillimin politik, ekonomik dhe demografik të Shqipërisë. Para vitit 1990, vendi përjetoj një rritje të qëndrueshme të popullsisë. Gjatë periudhës pasuese, normat e ulëta të lindshmërisë dhe emigracioni ishin faktorët kryesorë që kontribuan në zvogëlimin e popullsisë. Gjatë periudhës midis censeve 2001–2011, vlerësohet se rreth 500 mijë individë emigruan nga Shqipëria, me një mesatare prej rreth 50 mijë individë në vit. Ky trend emigracioni qëndron pothuajse i njëjtë me mesatarisht 50 mijë emigrant në vit edhe ndërmjet periudhës midis censeve 2011–2023.³

Shqipëria ende mbart një potencial të lartë emigrator, veçanërisht kanë ndikuar elemente të rëndësishme, si: afërsia kulturore, gjuhësore dhe gjeografike dhe kostoja e ulët e emigracionit në vendet fqinje, si Italia dhe Greqia, por edhe faktorë të tjerë që lidhen me mundësitë ligjore për bashkim familjar në vendet kryesore pritëse të emigrantëve. Faktor i rëndësishëm janë edhe rrugët e zgjeruara të emigracionit të ligjshëm, veçanërisht me shtetet e Bashkimit Evropian, si Gjermania dhe Franca.

Ndër faktorët kryesorë të emigracionit të shtetasve shqiptarë dominojnë ato me natyrë ekonomike, si papunësia dhe varfëria, por edhe faktorë të tjerë të lidhur me shërbimet e shëndetit, bashkimin familjar apo mundësitë profesionale.

Sipas të dhënave zyrtare të EUROSTAT-it, gjatë viteve 2022 dhe 2023 u evidentua një ndryshim i rëndësishëm në profilin e emigracionit të shqiptarëve jashtë vendit, duke reflektuar trende të ndryshme në preferencat e vendeve të destinacionit, por edhe faktorë ekonomikë dhe socialë që ndikojnë në lëvizjet migratore. Në nivel total, numri i emigrantëve shqiptarë në vitin 2023 shënoi një ulje në krahasim me vitin 2022, duke kaluar nga 861,927 në 840,704 persona, një rënie prej rreth 2.5%.⁴ Kjo tregon një tendencë të përgjithshme të ngadalësimit të emigracionit ose kthimit në atdhe, si pasojë e faktorëve të ndryshëm që lidhen me zhvillimet në vendet pritëse apo situatën ekonomike në Shqipëri.

Nga ana tjetër, ndryshimet më të theksuara në profilin e emigrantëve shqiptarë lidhen me vendet kryesore të destinacionit. Italia dhe Greqia, që historikisht kanë qenë dy destinacionet kryesore për emigrantët shqiptarë, regjistruan rënie në numrin e shqiptarëve të regjistruar në këto vende gjatë vitit 2023. Në Itali, numri i emigrantëve ra nga 404,985 në 376,351, një ulje prej rreth 7%, kurse në Greqi u regjistrua një rënie më e vogël, nga 319,690 në 315,771 emigrantë, që përbën një ulje prej rreth 1.2%. Këto ulje lidhen përgjithësisht me sfidat ekonomike dhe sociale që po përjetojnë këto vende, me politika migracioni më të rrepta apo edhe përmirësimin e kushteve të jetesës në Shqipëri.

³ Burimi: Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023
<https://www.instat.gov.al/media/14303/cens-2023.pdf>.

⁴ Burimi: Eurostat
<https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/bookmark/d80531d1-29f5-47b9-ac1f-58b58f04528c?lang=en>.

Në të kundërt, vendet e tjera të Bashkimit Evropian, veçanërisht Gjermania, Franca dhe disa vende të veriut të Evropës, shfaqën rritje të numrit të emigrantëve shqiptarë. Gjermania, për shembull, u rrit nga 75,765 në 82,311 emigrantë, që përfaqëson një rritje prej rreth 8.6%. Franca shënoi një rritje më të moderuar, nga 21,296 në 22,076, ose rreth 3.7%. Një rritje të dukshme shënuan edhe vende si Danimarka, që kaloi nga 558 në 755 emigrantë, rritje prej afro 35%, dhe Polonia që pothuaj dyfishoi numrin e emigrantëve shqiptarë, nga 855 në 1,431, rritje 67.4%. Kjo lëvizje drejt vendeve të Evropës Qendrore dhe Veriut mund të shpjegohet me mundësi më të mira pune, politika migracioni më të hapura dhe integrim më të lehtë për emigrantët.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është edhe stabiliteti relativ i numrit të emigrantëve në vende si Belgjika, Irlanda, Holanda dhe Zvicra, që tregojnë një rritje të moderuar prej 5–8%. Kjo tregon që këto vende janë bërë destinacione më të preferuara, për shkak të mundësive ekonomike dhe komuniteteve të konsoliduara shqiptare.

Nga ana tjetër, disa vende të vogla, si: Qipro, Letonia, dhe Lihtenshtajni, shfaqin një numër shumë të vogël emigrantësh shqiptarë dhe madje një rënie, që lidhet kryesisht me kapacitetet e vogla ekonomike dhe demografike të këtyre vendeve për të tërhequr emigrantë në masë.

Italia dhe Greqia vazhdojnë të jenë destinacionet kryesore, megjithëse me rënie të ndjeshme në numrin e emigrantëve shqiptarë, duke përbërë rreth 45–46% të totalit të emigrantëve në vitin 2023. Në të njëjtën kohë, Gjermania është rritur në rëndësi, duke përbërë rreth 10% të totalit, duke reflektuar një ndryshim gradual në preferencat migratore.

Në përmbledhje, shifrat e EUROSTAT-it tregojnë se emigracioni shqiptar vazhdon të jetë një fenomen kompleks dhe në ndryshim të vazhdueshëm. Për shkak të sfidave ekonomike dhe sociale në vendet tradicionale pritëse si Italia dhe Greqia, një pjesë e emigrantëve shqiptarë po drejtohet drejt vendeve të tjera të Evropës, veçanërisht Gjermanisë dhe vendeve të Veriut dhe Qendrore të Evropës. Kjo ndryshon edhe strukturën socio-ekonomike të komuniteteve shqiptare në emigracion, duke përhapur ndikimin e diasporës në një territor më të gjerë dhe duke krijuar mundësi të reja për integrim dhe zhvillim.

Referuar të dhënave zyrtare të EUROSTAT-it, numri i emigrantëve shqiptarë jashtë vendit rezulton si në tabelën 2.1.

Tabela 3.1.1: Emigrantët shqiptar sipas vendeve të destinacionit (2022 dhe 2023)

SHTETI I DESTINACIONIT	EMIGRANTË SHQIPTARË	
	Viti 2022	Viti 2023
Belgjikë	6,589	7,080
Bullgari	690	772
Republika Çeke	664	733
Danimarkë	558	755
Gjermani	75,765	82,311
Estoni	58	63
Irlandë	1,159	1,292
Greqi	319,690	315,771
Spanjë	2,918	3,317
Francë	21,296	22,076
Kroaci	2,977	3,265
Itali	404,985	376,351
Qipro	168	159

Letoni	23	20
Lituani	101	119
Luksemburg	840	913
Hungari	897	857
Maltë	4,221	4,494
Holandë	1,837	1,931
Austri	2,622	2,831
Poloni	855	1,431
Portugali	98	117
Rumani	1,168	1,079
Slloveni	327	409
Sllovaki	878	1,460
Finlandë	1,264	1,633
Suedi	5,604	5,473
Islandë	205	243
Lihtenshtajni	4	5
Norvegji	485	394
Zvicër	2,981	3,350
TOTAL	861,927	840,704

Burimi: EUROSTAT-i.

Migracioni shqiptar në botë, për vitin 2024, paraqet një profil të qartë të shpërndarjes së diasporës, ku disa shtete evropiane dhe anglishtfolëse mbajnë përqindjet më të larta të shtetasve shqiptarë me qëndrim të ligjshëm. **Sipas të dhënave të raportuara nga Misionet Diplomatike dhe Konsullore të Shqipërisë**, numri më i madh i emigrantëve shqiptarë gjendet në SHBA (224,000 persona), që përbën rreth 20% të totalit të regjistruar. Pas saj renditet Italia me rreth 389,646 shqiptarë, që përbën afro 35% të totalit, ndërsa Greqia mban vendin e tretë me rreth 264,657 persona, afërsisht 24%. Këto tri shtete së bashku përbëjnë mbi 79% të shqiptarëve të regjistruar jashtë vendit.

Në Evropën Perëndimore, Gjermania është një tjetër destinacion i madh me rreth 119,795 shqiptarë, që përbën rreth 10.8% të totalit. Edhe Mbretëria e Bashkuar shfaq një komunitet të madh me 100,000 shtetas, duke përfaqësuar 9% të numrit total.

Shtetet e tjera si Franca (22,078), Kanadaja (17,270) dhe Suedia (10,453) pasqyrojnë përhapjen gjithnjë e më të gjerë të emigracionit shqiptar përtej zonës ballkanike dhe evropiane. Në vendet e Gjirit, si Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Arabia Saudite, janë respektivisht 1,500 dhe 400 shqiptarë, që dëshmojnë për lëvizje ekonomike drejt vendeve me kërkesë për fuqi punëtore.

Narrativa migratore shqiptare për 2024 tregon vazhdimësinë e emigracionit ekonomik drejt vendeve me mirëqenie më të lartë, me rrënjë historike në shtete si Italia e Greqia, por edhe me zgjerim drejt vendeve të reja anglishtfolëse e të zhvilluara. Kjo shpërndarje tregon për një diasporë të konsoliduar, por edhe për sfidat që lidhen me integrimin dhe ruajtjen e identitetit kulturor.

Tabela 3.1.2: Shtetasit shqiptarë në botë për vitin 2024

Shteti	Misionet Diplomatike dhe Postet Konsullore–shtetet e tjera që mbulojnë	Janar–dhjetor 2024
Arabia Saudite	Riad/Bahrein/Oman/Jemen	400

Austri	Vjenë	2,986
Belgjikë	Bruksel	7,080
	Luksemburg	1,106
Brazil	Brazilia	-
Bullgari	Sofje	242
Çeki	Pragë	736
Danimarkë	Kopenhagen	774
Emiratet e Bashkuara Arabe	Abu Dhabi	1,500
Francë	Paris	22,078
Gjermani	Berlin	119,795
Greqi	Athinë Selanik	264,657
	Janinë	-
Hungari	Budapest	924
Itali	Romë Milano Bari	389,646
	Tokio	250
Japoni	Tokio	250
Kanada	Otave	17,270
Katar	Doha	246
Kinë	Pekin	130
Kroaci	Zagreb	3000
Mbretëria e Bashkuar	Londër	100,000
Serbi	Beograd	471
SHBA		
		224,000
Sllovaki	Bratislavë	1,519
Spanjë	Madrid	7,274
Suedi	Stokholm	10,453
	Norvegji	1,324
	Islandë	249
	Finlandë	2,329
Turqi	Ankara	1,827
Zvicër	Bernë	3,340


Burimi: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

INSTAT-i, mbi vlerësimin e numrit të përgjithshëm të shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit (diaspora), përdor vlerësime të tërthorta duke bërë krahasimin e dy popullsive, përllogaritje e popullsisë banuese vlerësuar më 1 janar dhe regjistrin civil.

Referuar publikimit më të fundit mbi diasporën nga INSTAT-i në vitin 2020, sipas vlerësimeve të tërthorta, numri i diasporës së re (pas viteve 1990) llogaritet të jetë rreth 1,68 milionë shtetas jashtë vendit ose rreth 37% të shtetasve shqiptarë gjithsej.

Grupmosha (0–14 vjeç) është rreth 19%, pjesën kryesore e zë grupmosha (15–64 vjeç), me rreth 76% dhe ajo mbi 65 vjeç, afërsisht 5%.

Figura 3.1.1: Piramida e diasporës më 1 janar 2020L



Burimi: INSTAT-i.

Popullsia banuese në Shqipëri, sipas numërimit në momentin e censit, mesnatën e së dielës dhe mëngjesin e së hënës 17–18 shtator 2023, rezulton 2,402.113, prej të cilëve, 49,6 për qind janë meshkuj dhe 50,4 për qind femra.

Në fund të vitit 2023, Shqipëria regjistroi një rritje të ndjeshme të numrit të të huajve që qëndrojnë në territorin e saj. Me një total prej 21,460 individësh, ky numër përfaqëson një rritje prej 18,2% krahasuar me vitin paraardhës, kur numëroheshin 18,151 të huaj. Kjo tendencë në rritje sinjalizon një interes të shtuar për qëndrimin në Shqipëri, i cili lidhet me faktorë të ndryshëm ekonomikë, socialë apo gjeopolitikë.

Struktura gjinore e këtij grupi tregon një dominim të theksuar të meshkujve, të cilët përbëjnë 63,8% të numrit të përgjithshëm të të huajve me leje qëndrimi, ndërsa femrat përfaqësojnë 36,2%. Kjo disbalancë reflekton motive të ndryshme që i sjellin të huajt në Shqipëri, si për shembull angazhimet në sektorë të caktuar pune ku burrat janë më të përfaqësuar ose modele migrimi të lidhura me qëllime individuale dhe profesionale, që preferojnë ardhjen e burrave përpara bashkimit familjar.

Në fund të vitit 2024, numri i të huajve me leje qëndrimi u rrit në 21,940, që përbën një rritje prej 480 personash ose rreth 2.24% më shumë në krahasim me vitin 2023. Kjo rritje modeste tregon një trend pozitiv dhe një interes të qëndrueshëm të shtetasve të huaj për të qëndruar në Shqipëri, çka mund të lidhet me faktorë si mundësitë e punësimit, arsimit ose politika më të hapura migratore.

Tabela 2.1.3: Të huaj me qëndrim në Shqipëri në fund të vitit (2023–2024).

	2023	2024
Të huaj me leje qëndrimi	21,460	21,940

Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin.

4. MIGRACIONI I RREGULLT I FOKUSUAR NË MIGRACIONIN PËR PUNËSIM

4.1 Autoritetet përgjegjëse shtetërore

Ministria e Brendshme, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit për Migracionin dhe Azilin (Drejtorisë së Politikave të Migracionit, Azilit dhe Antitrafikut) dhe Policisë së Shtetit (Departamenti për Kufirin dhe Migracionin) është institucioni kryesor përgjegjës për menaxhimin e migracionit dhe integrimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë.

Drejtoria e Politikave të Migracionit, Azilit dhe Antitrafikut (sektori i migracionit) ka si prioritetet kryesor hartimin e legjislacionit, politikave dhe strategjive në fushën e migracionit, përgatitjen e raportprogreseve periodike mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit të Veprimit, ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve të integritetit evropian dhe të konventave ndërkombëtare të ratifikuara në fushën e migracionit, si dhe ndjekjen dhe koordinimin e aktiviteteve në kuadër të proceseve rajonale dhe ndërkombëtare për migracionin.

Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, i organizuar në nivel qendror dhe vendor, ka në ngarkim trajtimin e të huajve që hyjnë, tranzitojnë apo qëndrojnë në territorin shqiptar. Ai është përgjegjës për kontrollin kufitar dhe administrimin e procedurave të hyrjes, qëndrimit dhe kalimit tranzit, duke zbatuar kushtet dhe kriteret përkatëse. Gjithashtu, ky departament merret me shqyrtimin e aplikimeve për vizë dhe pajisjen e të huajve me leje qëndrimi, përfshirë edhe zgjatjen e tyre.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikës së vizave, si dhe negocimin e akteve të nevojshme të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e migracionit, mbështetjen e emigrantëve shqiptarë jashtë vendit dhe mbrojtjen të drejtave të tyre, organizimin e diasporës shqiptare dhe të strukturimit të angazhimit të komuniteteve shqiptare jashtë vendit për zhvillimin ekonomik, shoqëror e politik të Shqipërisë.

Drejtoria e Çështjeve Konsullore është struktura përgjegjëse në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme për trajtimin e të huajve, hartimin e politikave të hyrjes e të qëndrimit të tyre në Republikën e Shqipërisë. Kjo drejtori harton politikat e aktivitetit të shërbimit konsullor, monitoron dhe drejton këtë aktivitet.

Agjencia Kombëtare e Diasporës është strukturë me misionin të përfaqësojë e të nxisë politikat e bashkëpunimit dhe të ndërveprimit me të gjithë shqiptarët, duke nxitur e fuqizuar bashkëpunimin në të gjitha fushat me shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe shtetet ku ata banojnë.

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave shtetërore në fushën e punësimit, emigracionit dhe imigracionit të punës, arsimit dhe formimit profesional, marrëdhënieve të punës, inspektimit, sigurisë dhe shëndetit në punë, në fushën e sigurimeve shoqërore, si dhe procesin e bashkërendimit të punës për skemat e mbrojtjes shoqërore me vendet e tjera. MEKI është autoriteti shtetëror qendror, përgjegjës për trajtimin e marrëdhënieve të punësimit të të huajve në Republikën e Shqipërisë.

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive zbaton legjislacionin e miratuar në fushën e imigrimit dhe emigrimit të punës. Autoriteti shtetëror përgjegjës, në nivel vendor, për punësimin e të huajve, është zyra përkatëse e punësimit. Kjo agjenci në nivelin qendror, si dhe në zyrat përkatëse vendore të punësimit, informojnë shtetasit e huaj mbi kriteret, dokumentacionin dhe procedurat që duhet të ndiqen për t'u punësuar në territorin e RSH-së dhe janë përgjegjëse për lëshimin e autorizimeve për punësim.

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe i Shërbimeve Shoqërore mbikëqyr zbatimin e kërkesave ligjore të legjislacionit të punës për sigurimin e kushteve të denja të punës, për mbrojtjen e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre, për ligjshmëri në zbatimin e kohëzgjatjes së punës, për pagesën për punë të kryer në përputhje me legjislacionin, për sigurimin e çdo punëmarrësi, për higjienën dhe mirëqenien në vendin e punës, për punësimin e ligjshëm të fëmijëve, si dhe për çështje të tjera që lidhen ngushtë me marrëdhënien e punës.

4.2 Kuadri ligjor

Në maj të vitit 2024, u miratua Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024–2030 dhe Plani i saj i veprimit 2024–2026, me vizionin që “Deri në vitin 2030, në frymën e proceseve globale të migracionit dhe integritetit të Shqipërisë në BE, të ofrohet një përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj sfidave dhe mundësive të migracionit, në kuadrin e Shqipërisë”. Në mënyrë specifike në fushën e migrimit të punës kjo strategji synon zhvillimin e politikave për migracionin për motive punësimi, duke rritur ndikimin e migracionit në zhvillimin e vendit dhe promovimin e migracionit të rregullt, mbrojtjen e të drejtave të migrantëve dhe integritetin e tyre në shoqërinë shqiptare. Për shkak të karakterit ndërsektorial që ka migracioni i punës, institucionet e përfshira në realizimin e këtyre qëllimeve janë të shumta, duke përfshirë krahas institucioneve shtetërore dhe organizata joqeveritare që ofrojnë kontribut të rëndësishëm në këtë fushë.

Në përputhje me këto dokumente, ndërhyrjet e parashikuara për të cilat ka filluar puna gjatë vitit 2024, përfshijnë:

- Përmirësimin e kuadrit ligjor për migrimin e punës, nëpërmjet ndryshimit të vazhdueshëm të legjislacionit në fushën e imigrimit dhe emigrimit të punës, me qëllim përafrimin e plotë me *acquis* të BE-së dhe realizimin e detyrimeve të anëtarësimit në BE;

- Përmirësimin e veprimtarisë së aktorëve privatë të tregut të punës që kanë në fokus ndërmjetësimin dhe punësimin e shtetasve shqiptarë, siç janë agjencitë private të punësimi, me qëllim rritjen e eficiencës së tyre, rekrutimin etik dhe reduktimin e abuzimeve gjatë këtij procesi;

- Informimin e shtetasve shqiptarë në emigracion mbi mundësitë e punësimi dhe të tregut të punës në vend, nëpërmjet ndërveprimit digjital me emigrantët shqiptarë dhe të rikthyer, me qëllim informimin e tyre por dhe bashkëpunimit me organizatat qeveritare që punojnë në këtë drejtim dhe krijimit të stimuljeve për të promovuar kthimin e tyre;

- Lehtësimin e transferimit dhe njohjes së aftësive, kualifikimeve apo kompetencave të fituara në emigracion, nëpërmjet aplikimit të njohjes së të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal, njohjes së dokumenteve të certifikimit të lëshuara jashtë vendit dhe certifikimit të kurseve afatshkurtra të formimit profesional për të siguruar akses të shpejtë në tregun e punës në vend pas kthimit; si dhe

- Krijimin e mekanizmave për transportueshmërinë e të drejtave të sigurimeve shoqërore dhe përfitimeve të fituara nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve të reja për njohjen e kontributeve shoqërore.

Strategjia Kombëtare e Punësimi dhe Aftësive 2023–2030 dhe Plani i saj i Veprimit është një tjetër dokument i rëndësishëm për mobilitetin e fuqisë punëtore, e cila ka si vizion “Punësim cilësor dhe aftësim gjatë gjithë jetës për të gjithë”. Në fushën e migrimit të punës, kjo strategji ka si objektiv që të lehtësojë lëvizshmërinë e fuqisë punëtore, me qëllim përmbushjen e nevojave të tregut të punës në vend, nëpërmjet përmirësimit dhe ngritjes së sistemeve që mundësojnë punësimin dhe lëvizshmërinë. Institucionet e rëndësishme të përfshira në zbatimin e këtij objektivi janë ministria përgjegjëse për punësimin dhe institucioni përgjegjës për zbatimin e politikave të punësimi (AKPA).

Legjislacioni në fushën e migracionit të punës përbëhet nga dy ligje bazë si ligji nr. 79/2021, “Për të huajt” dhe ligji nr. 9668/2006, “Për emigrimin për motive punësimi”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të tyre. Ligji për të huajt synon të rregullojë hyrjen dhe qëndrimin për motive pune të shtetasve të huaj që dëshirojnë të punojnë në Republikën e Shqipërisë, ndërsa ligji për emigrimin për

motive punësimi synon të krijojë një kuadër rregullator dhe përmbledhës të parimeve kryesore në fushën e emigrimit të punës. Zhvillimet e lidhura me kuadrin ligjor gjatë vitit 2024 kanë pasur në fokus hartimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore në ligjin 79/2021, “Për të huajt”, me synim rritjen e përafrimit të mëtejshëm me *acquis* të BE-së në fushën e imigrimit të punës, si dhe rregullimin e problematikave të hasura gjatë zbatimit të tij nga institucionet zbatuese.

Integrimi evropian dhe angazhimet e institucioneve shtetërore shqiptarë për të përparuar në këtë proces janë shprehur në dokumentet e pozicioneve negociuese për çdo kapitull. Fusha e migrimit të punës është veçanërisht e lidhur me zhvillimet në kapitullin 2 “Liria e lëvizjes për punëtorët”, kapitullin 24 “Liri, drejtësi dhe siguri”, kapitullin 3 “E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime” dhe kapitullin 19 “Politikat sociale dhe inovacioni”. Gjatë vitit 2024 institucionet shtetërore punuan për hartimin e këtyre dokumenteve duke kaluar në një tjetër hap të punës për të realizuar integrimin në BE.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme si autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e kërkesave për vizë, ka përmirësuar sistemin *online* të vizës për lehtësimin e procedurës së aplikimit për vizë elektronike apo vizë pullë pranë Misioneve Diplomatie dhe Posteve Konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë. Gjithashtu, për të rritur sigurinë e vizës elektronike shqiptare, është lancuar verifikimi i vizave nëpërmjet portalit qeveritar *e-visa.al*. Ku shtetasit e huaj mund të verifikojnë lehtësisht vizat e tyre elektronike si për qëndrim afatshkurtër dhe ato për qëndrim afatgjatë. Së bashku me autoritetet përgjegjëse të parashikuara në legjislacionin për të huajt, kryhen verifikime periodike për kushtet e akomodimit, qëndrimit të shtetasve të huaj pranë subjekteve shqiptare.

4.3 Statistikat

Në Shqipëri, aktivitetet fitimprurëse, bashkimi familjar dhe studimi mbeten arsyt më të zakonshme për aplikimet për leje qëndrimi të shtetasve të huaj. Sipas të dhënave nga Departamenti i Kufirit dhe Migracionit, në fund të vitit 2024, numri i të huajve me leje qëndrimi u rrit në 21,940, që përbën një rritje prej 480 personash ose rreth 2.24% më shumë në krahasim me vitin 2023.

Kjo rritje modeste tregon një trend pozitiv dhe një interes të qëndrueshëm të shtetasve të huaj për të qëndruar në Shqipëri, që lidhet me faktorë si mundësitë e punësimit, arsimimit ose politikat e hapura migratore.

Në lidhje me motivet e aplikimit për leje qëndrimi në vitet 2023 dhe 2024, vërehen ndryshime interesante. Numri i aplikimeve për bashkim familjar u ul nga 2,249 në 2,019, një rënie prej rreth 10%. Ndërkohë, aplikimet për punëmarrës janë rritur ndjeshëm nga 6,866 në 7,613, një rritje prej rreth 10.8%. Ky fakt tregon një rritje të interesit për punësim në Shqipëri si motiv kryesor për qëndrimin e të huajve. Nga ana tjetër, aplikimet për vetëpunësim ose investim ranë nga 662 në 584, që është një ulje prej rreth 11.7%. Aplikimet për leje qëndrimi me motiv studimi u rritën nga 815 në 877, duke shënuar një rritje prej rreth 7.6%, që tregon interes të vazhdueshëm të studentëve të huaj për edukimin në Shqipëri.

Në vitin 2024, gjithashtu, u rrit numri i lejeve të lëshuara për arsye humanitare (nga 133 në 140) dhe për arsye të tjera (nga 1,661 në 1,865). Një risi ishte lëshimi i disa lejeve nën iniciativën *Open Ballkan*, që filloi me 6 raste testuese.

Nga ana tjetër, lejet e përhershme të qëndrimit shënuan një ulje të ndjeshme, nga 138 në 72, që mund të tregojë një reduktim në aplikimet për qëndrim afatgjatë ose ndryshime në kriteret për to.

Rritja më e madhe vërehet në sektorin e punësimit, ndërsa bashkimi familjar dhe vetëpunësimi kanë pasur luhatje. Origjina dhe përbërja gjinore e të huajve reflektojnë tendencat e përgjithshme të migracionit në vend dhe ndryshimet në politikat migratore.

Tabela 4.3.1: Leje qëndrimi/ unike të lëshuara për herë të parë, sipas motivit.

Nr.	Motivi i qëndrimit	Viti 2023	Viti 2024
-----	--------------------	-----------	-----------

Burimi:

1	Bashkim familjar	2,249	2,019
2	Unike-punëmarrës	6,866	7,613
3	Unike-vetëpunësim/investitor	662	584
4	Humanitare	133	140
5	Studime	815	877
6	Të tjera	1,661	1,865
7	I përhershëm	138	72
8	Open Ballkan	-	6 (test)
Total		12,524	13,176

Departamenti i Kufirit dhe Migracionit

Në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, shtetasit e huaj që dëshirojnë të qëndrojnë ligjërisht në territorin e Republikës së Shqipërisë për qëllime pune, aplikojnë dhe pajisen me leje unike. Kjo leje integron në një leje të vetme miratimin për punësim dhe lejen e qëndrimit.

Gjithashtu, në varësi të shtetësisë, motivit për të cilin vijnë në Shqipëri, aktivitetit që do të ushtrojnë, si dhe kohëzgjatjes së qëndrimit, shtetasit e huaj pajisen me dokumentin e lejes së qëndrimit apo lejes unike në përputhje me motivin e dëshiruar. Për t’u pajisur me këto autorizime të huajt duhet të plotësojnë kriteret, procedurat dhe dokumentacionin e parashikuar në vendimin nr. 858, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave dhe të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Autoriteti shtetëror përgjegjës për menaxhimin e çështjeve të punësimit të shtetasve të huaj në Shqipëri është Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA), përmes Drejtorive Rajonale të Punësimit dhe Aftësive (DRAKPA), që veprojnë në varësinë e saj.

Gjatë vitit 2024, AKPA-ja ka trajtuar gjithsej 11,224 aplikime *online* për pajisje me leje unike për qëndrim dhe punë për shtetasit e huaj. Nga këto:

- 3,199 aplikime (28%) i përkasin shtetaseve femra;
- 8,014 aplikime (71%) përfaqësojnë kërkesa për herë të parë.

Sa i përket ndarjes sipas llojit të aplikimit, rezulton se: 9,419 janë miratime për punësim, ndërsa 1,805 janë deklarime punësimi, prej të cilave 1,314 nga shtetas të vendeve anëtare të BE-së dhe 491 nga vende të Ballkanit Perëndimor.

Këto të dhëna pasqyrojnë rritjen e ndjeshme të përdorimit të procedurave të digjitalizuara dhe nevojën për kapacitete të shtuara administrative në menaxhimin e flukseve të punësimit të shtetasve të huaj në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe standardet e BE-së.

Tabela 4.3.2: Të huajt të trajtuar nga AKPA-ja për vitet 2023–2024

Shtetas të huaj me kontratë pune	Viti 2023	Viti 2024
Total	9,825	11,224

Burimi: AKPA-ja.

Të dhënat e raportuara nga AKPA-ja dhe Drejtoritë Rajonale të Punësimit dhe Aftësive për vitet 2023 dhe 2024, tregojnë një rritje të ndjeshme prej afro 14% në numrin total të të huajve të trajtuar për punësim dhe leje pune, duke kaluar nga 9,825 raste në vitin 2023 në 11,224 në vitin 2024. Kjo rritje pasqyron një interesim në rritje për tregun shqiptar të punës nga shtetas të huaj dhe, njëkohësisht, një zgjerim të aktiviteteve të menaxhimit institucional.

Analiza sipas qarqeve tregon se Tirana mbetet epiqendra kryesore e punësimit të të huajve, me një rritje prej rreth 30%, nga 4,207 raste në vitin 2023, në 5,477 raste në vitin 2024. Kjo rritje e fortë reflekton rolin e kryeqytetit si qendra kryesore ekonomike dhe administrative e vendit.

Shkodra shënon, gjithashtu, një rritje të ndjeshme, me 646 raste në vitin 2024, krahasuar me 435 në vitin 2023, çka sugjeron një rritje të kërkesës për fuqi punëtore të huaj në veri të vendit.

Elbasani përjeton një rritje të qëndrueshme, nga 331 në 2023 në 438 në 2024, duke treguar aktivizim të tregut rajonal të punës. Qarqe të tjera, si: Berati, Fieri, Vlora dhe Durrësi shfaqin rënie të lehta ose stabilitet, duke reflektuar ndoshta një treg më të konsoliduar ose ndryshime në dinamikat lokale të punësimit.

Nga ana tjetër, qarqe më të vogla, si: Dibra, Gjirokastra, Kukësi dhe Korça paraqesin një rritje graduale, por me shifra absolute ende modeste, duke sinjalizuar një shtrirje më të ngadaltë të prezencës së të huajve në këto zona për shkak të mungesës së mundësive të mëdha të punësimit apo infrastrukturës mbështetëse.

Tabela 4.3.3: Të huaj të trajtuar nga AKPA-ja dhe drejtoritë rajonale, për vitet 2023–2024.

Institucioni	Viti 2023	Viti 2024
Berat	302	144
Dibër	51	74
Durrës	2006	1909
Elbasan	331	438
Fier	592	573
Gjirokastrë	98	132
Korçë	110	119
Kukës	71	82
Lezhë	424	435
Shkodër	435	646
Tiranë	4207	5477
Vlorë	1208	1195
Total	9,825	11,224

Burimi: AKPA-ja

Tabela tregon një shumëllojshmëri sektorësh ekonomikë dhe shpërndarjen e punësimit në secilin sektor, duke përfshirë formimin profesional dhe tipin e punësimit. Sektori i akomodimit dhe shërbimi ushqimor (1,580 punëtorë) ka numrin më të madh të punonjësve, me një numër të konsiderueshëm punonjësish me kualifikim të lartë (1,502), si dhe një pjesë të vogël punëmarrësish dhe punëtorësh sezonal (22). Ky sektor është tipik për turizmin dhe mund të tregojë një lidhje të fortë me migracionin sezonal, veçanërisht në rastin e punës sezonale (punëtorë stinorë).

Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave (1,339 punëtorë), gjithashtu, tregon një shpërndarje të gjerë të punësimit, ku dominon numri i punëmarrësve (1,256), që është një tjetër tregues i rëndësishëm për sektorët me punësim masiv.

Sektorët me punësim më të paktë janë shërbimet administrative dhe mbështetëse me një numër të vogël punonjësish (15) dhe nuk ka punëmarrës apo punësime sezonale, si dhe sektorë si furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave që, gjithashtu, ka një numër të vogël të punësuarish, me vetëm 15 individë të angazhuar, që mund të tregojë se ky sektor është më pak i kërkuar nga të huajt.

Në disa sektorë ka dominim të formave të caktuara të punësimit: punëmarrës: sektorët si akomodimi dhe shërbimi ushqimor, tregtia me shumicë dhe me pakicë, ndërtimi dhe transporti, dhe magazinimi janë dominues në punësimin e punëmarrësve, duke reflektuar natyrën e punës që kërkon angazhim të vazhdueshëm dhe pa ndërprerje. Punëtorë stinorë:

Në sektorë si akomodimi dhe shërbimi ushqimor, dhe transporti dhe magazinimi, punëtorët stinorë janë të zakonshëm, duke sugjeruar migracion sezonal dhe lëvizje të punëtorëve në periudha të caktuara të vitit. Të vetëpunësuar: Ky tip i punësimit është i pranishëm në sektorë si aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike dhe aktivitetet e organizatave ndërkombëtare, ku individët mund të kenë mundësi më të mëdha për të zhvilluar karriera të pavarura.

Akomodimi dhe shërbimi ushqimor: 1,580 individë nga gjithsej 11,224 punëtorë (14.07% e punësimit total). Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave: 1,339 individë nga gjithsej 11,224 (11.91% e punësimit total). Aktivitetet të tjera shërbimi: 1431 individë nga gjithsej 11,224 (12.75% e punësimit total). Ndërtimi: 1,422 individë nga gjithsej 11,224 (12.67% e punësimit total).

Të huajt migrantë janë integruar kryesisht në sektorë si akomodimi dhe shërbimi ushqimor, ndërtimi, dhe tregtia, veçanërisht për individët që kërkojnë punë për periudha të caktuara të vitit, ndërsa sektorët si aktivitetet profesionale dhe teknike mund të tërheqin individë të pavarur që kërkojnë mundësi më të lira punësimi.

Tabela 4.3.4: Sipas sektorit të aktivitetit dhe tipit të punësimit.

<i>Aktivitete ekonomike</i>	<i>Formim profesional</i>	<i>Me kualifikim të lartë</i>	<i>Punëmarrës</i>	<i>Punët. stinor</i>	<i>Shërbime kontraktuese</i>	<i>Sportistë</i>	<i>Të vetëpunësuar</i>	<i>Transferuar brenda ndërmarrjes</i>	<i>Vullnetarë</i>	<i>Total</i>
Ind. përpunuese – industri të tjera përpunuese	-	3	941	-	-	-	7	-	-	951
Ind. përpunuese - prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri; i letrës dhe i produkteve prej letrës, shtypshkrimet	-	-	203	-	-	-	1	-	-	204
Administrimi publik dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm	-	1	5	-	2	-	-	-	-	8
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	-	1	1502	22	-	-	55	-	-	1580
Aktivitete financiare dhe të sigurimit	-	4	44	-	1	-	4	-	-	53

Aktivite të profesionale, shkencore dhe teknike	-	-	15	-	-	4	22	-	-	41
Aktivite të organizatave dhe organizmave ndërkombëtarë	-	12	158	-	6	4	-	-	468	648
Aktivite të pasurive të paluajtshme	-	-	86	-	-	-	17	-	-	103
Aktivite të tjera shërbimi	2	26	1196	3	4	-	195	-	5	1431
Aktivitetet të familjeve si punëdhënës	-	-	36	-	-	-	-	-	1	37
Arsimi	-	138	110	-	4	-	8	-	8	268
Arte, argëtim dhe çlodhje	-	2	218	1	3	95	7	-	5	331
Bujqësia, pyjet, peshkimi	-	2	585	-	-	-	4	-	1	592
Energjia elektrike, gaz, avull, ajër i kondicionuar	-	3	99	-	11	-	1	-	-	114
Furnizimi me ujë, aktivite të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	-	-	14	-	-	-	1	-	-	15
Ind. përpunuese – përpunimi i produkteve ushqimore, pijeve dhe produkteve të duhanit	-	-	168	-	-	-	1	-	-	169
Ind. përpunuese – përpunimi i tekstileve, konfeksionimi i veshjeve dhe prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	-	-	464	-	-	-	3	-	-	467
Industria nxjerrëse	-	4	389	-	1	-	3	-	-	397

Informacioni dhe komunikacioni	-	22	297	-	-	-	35	-	-	354
Ndërtimi	-	20	1328	2	53	1	18	-	-	1422
Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale	-	23	193	-	-	-	8	-	2	226
Shërbime administrative dhe mbështetëse	-	3	5	-	1	-	3	-	3	15
Transporti dhe magazinimi	-	234	214	-	-	-	11	-	-	459
Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	-	8	1256	-	1	-	72	1	1	1339
Total	2	506	9,526	28	87	104	476	1	494	11,224

Burimi: AKPA-ja.

Gjatë vitit 2024, sipas të dhënave të Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim (AKPA), në zbatim të nenit 74, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, janë miratuar një numër i konsiderueshëm lelesh punësimi për shtetas të huaj, duke pasqyruar një dinamikë të qartë të nevojës për fuqi punëtore në sektorë kyç të ekonomisë shqiptare. Pjesa më e madhe e të huajve të punësuar vijnë nga India, me një peshë prej afro 37% të miratimeve në këtë kategori, duke u ndjekur nga Filipinet dhe Turqia, përkatësisht me rreth 24% dhe 22%. Kjo shpërndarje tregon një orientim të theksuar drejt tregjeve të punës nga Azia, si dhe një prirje për të përfshirë punëtorë nga vende me përvojë në sektorë të shërbimeve apo ndërtimit. Egjiptianët përbëjnë, gjithashtu, një grup të rëndësishëm, duke zënë rreth 17% të miratimeve sipas shtetësisë.

Tabela 4.3.5: Miratime punësimi sipas shtetësisë 2024

Shtetësia	Miratime punësimi
Indiane	2,124
Filipineze	1,350
Turke	1,273
Egjiptiane	1,001

Burimi: AKPA-ja.

Në aspektin sektorial, kërkesa më e lartë për punonjës të huaj është regjistruar në sektorin e akomodimit dhe shërbimeve ushqimore, i cili përbën afro një të tretën e të gjithë miratimeve të punësimit sipas sektorit. Kjo lidhet drejtpërdrejt me zgjerimin e sektorit të turizmit në Shqipëri dhe nevojën për personel të specializuar apo me përvojë në këtë fushë. Sektori i ndërtimit ndjek nga afër, duke reflektuar zhvillimet intensive në infrastrukturë dhe ndërtime civile. Edhe sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë, së bashku me shërbimet e tjera, kontribuojnë ndjeshëm në absorbimin e punëtorëve të huaj, duke dëshmuar për një rritje të përgjithshme të kërkesës për fuqi punëtore në ekonomi.

Tabela 4.3.6: Miratime punësimi sipas sektorit të aktivitetit 2024

Sektori i aktivitetit	Miratime punësimi
Akomodim shërbim ushqimor	1,408
Aktivite të tjera shërbimi	1,133
Sektori i ndërtimit	1,288
Sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë	1,157

Burimi: AKPA-ja.

Nga pikëpamja e tipit të punësimit, përqindja më e lartë e miratimeve, mbi 92%, u takon të huajve të punësuar me kontrata pune, që tregojnë qartazi se Shqipëria vazhdon të mbështetet kryesisht në forma tradicionale punësimi për të plotësuar mungesat në tregun e punës. Ndërkohë, shërbimet vullnetare dhe punësimi me kualifikim të lartë përbëjnë një përqindje shumë më të ulët, rreth 6% në total, duke treguar se ende mbetet hapësirë për zhvillimin e politikave që nxisin përfshirjen e të huajve në pozicione që kërkojnë ekspertizë apo që mbështesin misionet sociale. Të vetëpunësuarit përfaqësojnë një kategori minimale, gjë që sugjeron se klima aktuale ligjore dhe ekonomike nuk e favorizon ende mjaftueshëm këtë formë alternative të punësimit.

Tabela 4.3.7: Miratime punësimi sipas tipit të punësimit

Tipi i punësimit	Miratime punësimi
Të punësuar	8,548
Shërbime vullnetare	339
Me kualifikim të lartë	200
Të vetëpunësuar	153

Burimi: AKPA-ja.

Në tërësi, këto të dhëna dëshmojnë për një profil të qartë të migracionit të rregullt për punë në Shqipëri, të dominuar nga punësimi i zakonshëm në sektorë me intensitet të lartë pune dhe nga shtetësi me prani tradicionale në tregjet ndërkombëtare të punës. Kjo situatë ofron një bazë të rëndësishme për orientimin e politikave të ardhshme në drejtim të diversifikimit të burimeve të punës së huaj dhe fuqizimit të trajtimit të drejtë dhe të integruar të të huajve në tregun shqiptar të punës.

Siç edhe përcaktohet në nenin 80, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, shtetas të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, anëtarët e familjes së shtetasve të SHBA-ve, shtetas të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të zonës *Schengen* dhe anëtarët e familjeve të tyre, që nuk janë shtetas të këtyre vendeve dhe që janë me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë, shtetasit e njërit prej vendeve të Ballkanit Perëndimor, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi, Kosovës, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut, deklarojnë punësimin e tyre pranë zyrave përkatëse.

Gjatë vitit 2024, në Shqipëri janë deklaruar gjithsej 1,805 shtetas të huaj për qëllime punësimi, prej të cilëve 1,314 ishin nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe 491 nga Ballkani Perëndimor, duke përfaqësuar përkatësisht 72.8% dhe 27.2% të totalit. Kjo ndarje konfirmon një prirje të qartë drejt një prezence më të theksuar të shtetasve nga vendet e BE-së në tregun shqiptar të punës.

Një element domethënës është se 1,329 deklarime ose 73.6% e totalit përbëhen nga persona që janë deklaruar për herë të parë në sistemin e punësimit, me 950 të tillë nga BE-ja (rreth 72% e këtij grupi) dhe 379 nga Ballkani Perëndimor (rreth 28%), duke dëshmuar për një fluks të konsiderueshëm të hyrjeve të reja nga të dyja grupet.

Sa i përket përfaqësimit gjinor, nga 1,805 të huaj të deklaruar, 491 janë gra, që përbëjnë 27.2% të totalit, me një dominim të shtetaseve nga BE-ja (380 gra ose 77.4% e të gjithë grave të deklaruar), ndërkohë që 91 gra vijnë nga Ballkani Perëndimor (18.5% e grave).

Në analizën sipas shtetësisë brenda BE-së, shtetasit italianë përbëjnë grupin më të madh me 678 deklarime, që përbën 51.6% të të gjithë deklarimeve nga BE-ja. Pas tyre vijnë gjermanët (105 ose 8%),

polakët (84 ose 6.4%) dhe rumunët (67 ose 5.1%), duke treguar se katër shtete përbëjnë mbi 71% të deklarimeve totale të shtetasve të BE-së në Shqipëri.

Për sa i përket shtetasve të Ballkanit Perëndimor, dominon ndjeshëm Kosova me 229 deklarime ose 46.6% e të gjithë këtij grupi, pasuar nga shtetasit nga Maqedonia e Veriut (168 ose 34.2%), Serbia (8.3%), Bosnja (6.3%) dhe Mali i Zi (4.5%). Kjo tregon një prani të fortë nga vendet më afër Shqipërisë si në aspektin gjeografik ashtu edhe në lidhjet historike dhe gjuhësore.

Tabela 4.3.8: Deklarime sipas shtetësisë (shtetas të BE-së)

Shtetësia	Deklarime punësimi
Italiane	678
Gjermane	105
Polake	84
Rumune	67

Burimi: AKPA-ja.

Sa i takon sektorëve të punësimit, ndarja është e njëjtë për të dyja grupet, duke reflektuar një strukturë të ngjashme të kërkesës së tregut për të huajt. Sektorët më të përfaqësuar janë “aktivitete të tjera shërbimi” me 247 deklarime, që përbëjnë 18.8% të totalit për secilin grup, pasuar nga “transport dhe magazinim” me 220 deklarime (16.7%), “organizata ndërkombëtare” me 211 (16%) dhe “akomodim dhe shërbim ushqimor” me 107 (8.1%).

Kjo tregon për një përqendrim në sektorë ku kërkohen kompetenca praktike, fleksibilitet dhe ndërveprim ndërkombëtar.

Tabela 4.3.9: Deklarime sipas sektorit të aktivitetit (shtetas të BE-së)

Sektori i aktivitetit	Deklarime punësimi
Aktivitete të tjera shërbimi	247
Sektori i transportit dhe magazinimit	220
Aktivitete të organizatave dhe organizmave ndërkombëtarë	211
Akomodim dhe shërbim ushqimor	107

Burimi: AKPA-ja.

Në lidhje me tipin e punësimit, ndër shtetasit e BE-së, 599 janë të punësuar në marrëdhënie të rregullt pune (45.6%), ndërsa një përqindje e konsiderueshme janë të vetëpunësuar (273) (20.8%) dhe punonjës me kualifikim të lartë (263) (20%). 147 janë të përfshirë në shërbime vullnetare (11.2%), duke sugjeruar për një larmi të formave të angazhimit, që përfshijn si profesionistë të pavarur ashtu edhe angazhime në fusha humanitare dhe sociale.

Tabela 4.3.10: Deklarime sipas tipit të punësimit (shtetas të BE-së)

Tipi i punësimit	Miratime punësimi
Të punësuar	599
Të vetëpunësuar	273
Me kualifikim të lartë	263
Shërbime vullnetare	147

Burimi: AKPA-ja.

Tabela 4.3.11: Deklarime sipas shtetësisë (shtetas të Ballkanit Perëndimor)

Shtetësia	Deklarime punësimi
Kosovare	229
Maqedonase	168
Serbe	41
Boshnjake	31

Malazeze	22
----------	----

Burimi: AKPA-ja.

Ndërkohë, shtetasit nga Ballkani Perëndimor paraqiten më të përqendruar në punësimin e zakonshëm: 379 janë të punësuar, që përbëjnë 77.2% të të gjithë këtij grupi. Të vetëpunësuarit janë vetëm 50 (10.2%), ndërsa me kualifikim të lartë janë 43 (8.8%), dhe vetëm 8 persona janë përfshirë në shërbime vullnetare (1.6%). Këto të dhëna tregojnë për një profil më të thjeshtë dhe më të ngushtë të përfshirjes së këtij grupi në tregun e punës, me theks në format tradicionale të punësimit dhe më pak diversitet profesional.

Tabela 4.3.12: Deklarime sipas sektorit të aktivitetit (shtetas të Ballkanit Perëndimor)

Sektori i aktivitetit	Deklarime punësimi
Aktivitete të tjera shërbimi	247
Sektori i transportit dhe magazinimit	220
Aktivitete të organizatave dhe organizmave ndërkombëtarë	211
Akomodim dhe shërbim ushqimor	107

Burimi: AKPA-ja.

Tabela 4.3.13: Deklarime sipas tipit të punësimit (shtetas të Ballkanit Perëndimor)

Tipi i punësimit	Miratime punësimi
Të punësuar	379
Të vetëpunësuar	50
Me kualifikim të lartë	43
Shërbime vullnetare	8

Burimi: AKPA-ja.

Në përfundim, të dhënat e vitit 2024 për deklaratimet e të huajve në Shqipëri për qëllime punësimi pasqyrojnë një prezencë më të madhe të shtetasve të BE-së, krahasuar me ata nga Ballkani Perëndimor. Shtetasit e BE-së jo vetëm që përbëjnë shumicën numerike, por paraqiten edhe më të shpërndarë në sektorë të ndryshëm, në forma të ndryshme të punësimit dhe me një përqindje më të lartë të angazhimeve të avancuara profesionale.

Ndërkohë, shtetasit nga Ballkani Perëndimor përfaqësohen më së shumti në sektorë bazë dhe në forma më të strukturuar punësimi, duke treguar një nevojë të mundshme për politika integruuese më të fokusuara dhe nxitëse për diversifikim dhe ngritje profesionale.

5. MIGRACIONI I PARREGULLT NË VEND

5.1 Autoritetet përgjegjëse

Ministria e Brendshme, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme për Zhvillimin e Migracionit dhe Azilit, strukturave të Policisë së Shtetit, Departamentit për Kufirin dhe Migracionin dhe Departamentit për Policinë Kriminale, ka përgjegjësinë kryesore në menaxhimin e migracionit të parregullt.

Departamenti për Kufirin dhe Migracionin (DKM), nëpërmjet strukturave të saj qendrore dhe vendore, është përgjegjës për:

- Parandalimin dhe luftën ndaj migracionit të parregullt nëpërmjet menaxhimit të integruar të kufijve;
- Kontrollit të ligjshmërisë së qëndrimit të të huajve në territor;
- Marrjen e masave për ndalimin e të huajve të parregullt në territor;
- Largimin vullnetar, dëbimin dhe kthimin e tyre në vendin e origjinës apo në vendin tranzit nga kanë ardhur;
- Zbatimin e marrëveshjeve të ripranimit me vendet e tjera;

- Pritjen, intervistimin e shtetasve shqiptarë emigrantë të parregullt të kthyer në kufi;
- Informimin e tyre mbi mundësitë e riintegrit në vend;
- Bashkëpunimin rajonal dhe më gjerë në fushën e shkëmbimit të të dhënave statistikore mbi migracionin e parregullt dhe paralajmërimin e hershëm;
- Përzgjedhjen e të huajve të parregullt në kufi a territor dhe referimin e tyre në mekanizmin përkatës;
- Identifikimin dhe trajtimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit të personave në zbatim të Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe Procedurave Standarde të Veprimit për identifikimin;
- Referimin dhe asistimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, përfshirë dhe të miturit e pashoqëruar, për luftën kundër trafikimit dhe kontrabandimit të personave.

Me qëllim kontrollin dhe menaxhimin efektiv të migracionit të parregullt, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin bashkëpunon dhe ndërvepron me Drejtorinë e Politikave të Migracionit, Azilit dhe Antitrafikut, në Ministrinë e Brendshme, e cila mbulon çështjet për migracionin, azilin dhe refugjatët në Shqipëri. Ajo është përgjegjëse për trajtimin e aplikimeve, procedimin, shqyrtimin e dëgjimeve dhe grumbullimin e të dhënave të tjera të nevojshme për plotësimin e dokumentacionit për çdo aplikim për azil.

Drejtoria e Politikave të Migracionit, Azilit dhe Antitrafikut, në Ministrinë e Brendshme merret me monitorimin, bashkërendimin, nxitjen dhe orientimin e veprimtarisë së strukturave qendrore/vendore në çështjet e parandalimit dhe luftës kundër trafikimit të personave, në zbatim të Planit Kombëtar të Veprimit të Luftës kundër Trafikimit të Personave, si dhe të çështjeve të migracionit, në veçanti të Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit të Veprimit.

5.2 Kuadri ligjor

Kuadri ligjor shqiptar për migracionin ka njohur përmirësime të ndjeshme në vitet e fundit, duke reflektuar përpjekjet për përafrimin me standardet e Bashkimit Evropian. Ligji nr. 79/2021, “Për të huajt”, së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, është harmonizuar me 15 direktiva të *acquis* të BE-së, duke krijuar një bazë ligjore më të plotë dhe efikase për menaxhimin e çështjeve të migracionit. Legjislacioni në fuqi rregullon një sërë aspektesh të rëndësishme, me fokus të veçantë në luftën kundër migracionit të paligjshëm. Ai përfshin procedurat për trajtimin e të huajve në situatë të parregullt, mbrojtjen e të miturve të pashoqëruar, si dhe masat kundër hyrjes dhe qëndrimit të paligjshëm, punësimit informal, martesave fiktive, apo qëndrimit në territor nëpërmjet formave abuzive. Po ashtu, ligji parashikon dispozita të qarta për ndalimin në qendrën e mbyllur, dëbimin dhe largimin nga territori, si dhe për masat ndëshkimore dhe mekanizmat për ekzekutimin e tyre, duke siguruar një qasje të strukturuar, në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Ky kuadër i avancuar ligjor përfaqëson një hap të rëndësishëm në përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë, në kuadër të procesit të integrit evropian dhe forcimin e sistemit kombëtar të menaxhimit të migracionit.

Ligji nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, përafruar po ashtu pjesërisht me një sërë direktivash të Këshillit dhe Parlamentit Evropian, ka për qëllim parashikimin e kushteve e të procedurave për dhënien dhe heqjen e azilit, mbrojtjen plotësuese dhe mbrojtjen e përkohshme në Republikën e Shqipërisë, të drejtat dhe detyrimet e azilkërkuesve, refugjatëve dhe personave nën mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese, përmbajtjen e statusit të refugjatit dhe mbrojtjes plotësuese, të drejtën për bashkim familjar, si dhe përcaktimin e kushteve për integrimin e refugjatëve e të personave nën mbrojtje plotësuese në Republikën e Shqipërisë.

Ndër politikat migratore të Ministrisë e Brendshme, mund të veçohet Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2020–2027 dhe Plani i Veprimit 2021–2023, si dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021–2023.

Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2020–2027 është konceptuar për bashkërendim dhe bashkëpunimin ndërmjet të gjithë autoriteteve dhe agjencive të përfshira në sigurinë kufitare dhe lehtësimin e tregtisë, me qëllim përsosjen e sistemeve të efektshme dhe me rendiment të menaxhimit të integruar të kufirit, me synim arritjen e qëllimit për të pasur kufij të hapur por të kontrolluar dhe të sigurt.

Me VKM-n nr. 458, datë 10.7.2024, u miratua Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024–2025 (PKV). Plani shpreh përkushtimin e qeverisë shqiptare, të institucioneve shtetërore dhe joshetërore dhe të aktorëve antitrafikim që punojnë në strukturat publike dhe jopublike, për të minimizuar fenomenin e trafikimit të personave. PKV-ja është dokumenti më i rëndësishëm politik kombëtar i cili koordinon aktorët shtetërorë, organizatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile në përpjekjet e përbashkëta për të luftuar trafikimin e personave.

PKV-ja është një shprehje e qartë e vullnetit të qeverisë shqiptare për të marrë të gjitha masat e nevojshme të karakterit institucional, ligjor dhe buxhetor për t'iu përgjigjur në mënyrë të koordinuar trafikimit të personave. Ky dokument është vazhdim i përpjekjeve dhe objektivave antitrafikim të parashikuara në Strategjinë kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025, sigurisht, të përshtatura me dinamikën e trafikimit, vizionin e ri qeverisës në qasjen ndaj fenomenit të trafikimit për të krijuar një platformë të mirëorientuar synimesh e objektivash strategjike, në përputhje me dokumentet e tjera strategjike kombëtare, si dhe bazuar në rekomandimet e partnerëve ndërkombëtarë. Bazat e ndërhyrjeve dhe veprimeve të përcaktuara në PKV mbeten parandalimi, hetimi dhe ndjekja, mbrojtja dhe riintegrimi social dhe ekonomik i viktimës/viktimës së mundshme të trafikimit.

Synimi strategjik i këtij dokumenti është realizimi i një sistemi të integruar të adresimit të të gjitha hallkave dhe elementeve që lidhen me trafikimin e personave dhe pasojat e tij, i cili bazohet në ndërveprimin efektiv institucional, brenda e jashtë vendit dhe bashkërendimin e veprimtarive.

Misioni i PKV-së është promovimi i një reagimi efektiv, adekuat dhe të bashkërenduar për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave, të bazuar në bashkëpunimin ndërkombëtar, bashkëpunimin efektiv ndërinstitucional brenda vendit, pjesëmarrjen e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit dhe përfshirjen e shoqërisë civile dhe komunitetit.

5.3 Menaxhimi i migracionit të parregullt

Bashkëpunimi në fushën e kthimit/ripranimeve

Gjatë vitit 2024, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin ka vijuar përmirësimin e kuadrit institucional dhe procedural në fushën e kthimit dhe ripranimeve, duke reflektuar zhvillimet më të fundit ligjore. Në këtë kuadër:

- Janë hartuar dhe janë në proces ndjekjeje procedurale marrëveshjet e ripranimit me vende të origjinës, si: Egjipti, Bangladeshi dhe Tunizia;

- Janë finalizuar një sërë aktesh nënligjore në zbatim të ligjit për të huajt, të cilat synojnë të rregullojnë më tej menaxhimin e migracionit të parregullt, të sigurojnë asistencë në tranzit për kthimet në rrugë ajrore, si dhe të mbështesin zhvillimin e operacioneve individuale dhe të përbashkëta të kthimit ajror.

Që prej vitit 2023, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin është përfutuesi kryesor i projektit rajonal për forcimin e kapaciteteve në fushën e ripranimit, i cili financohet nga qeveria daneze dhe menaxhohet nga Zyra Rajonale e IOM-it. Ky projekt mbulon periudhën kohore nga viti 2021 deri në qershor 2025 dhe synon të rrisë efikasitetin e strukturave përgjegjëse në procesin e ripranimit.

Kërkesa ripranimi të shtetasve shqiptarë (madhor) nga vende të BE-së dhe rajoni

Gjatë vitit 2024, në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Ripranimit ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian, si dhe marrëveshjeve dypalëshe të ripranimit, janë trajtuar dhe janë kthyer përgjigje për gjithsej 309 kërkesa për ripranim të shtetasve madhorë.

Për krahasim, gjatë vitit 2023 janë trajtuar 407 kërkesa për ripranim, duke rezultuar në një ulje prej 98 kërkesash në vitin 2024.

Gjermania ka qenë shteti që ka paraqitur numrin më të madh të kërkesave në të dyja vitet, me një rritje të lehtë në vitin 2024. Nga ana tjetër, ka pasur një ulje të ndjeshme të kërkesave të paraqitura nga Mbretëria e Bashkuar dhe Belgjika, të cilat në vitin 2023 kishin pasur shifra dukshëm më të larta. Një rënie e dukshme është regjistruar edhe nga Franca, Holanda dhe Luksemburgu, që në vitin 2024 kanë dërguar ndjeshëm më pak kërkesa se një vit më parë.

Ndërkohë, disa shtete që kishin paraqitur kërkesa gjatë vitit 2023, si: Finlanda, Bullgaria, Spanja dhe Kosova, nuk kanë paraqitur asnjë kërkesë në vitin 2024. Në të kundërt, shtete si: Norvegjia, Sllovenia dhe Mali i Zi, të cilat nuk kishin qenë pjesë e kërkesave në vitin 2023, kanë paraqitur kërkesa për herë të parë në vitin 2024, ndonëse në numër shumë të kufizuar.

Më poshtë tabela 5.3.1 sipas shteteve

Nr.	Shteti	Kërkesa 2023	Kërkesa 2024
1	Gjermania	166	171
3	Belgjika	67	46
4	Anglia	108	74
2	Franca	18	3
5	Polonia	0	0
8	Finlanda	6	0
7	Luksemburgu	10	5
9	Holanda	22	7
10	Suedia	0	0
11	Bullgaria	8	0
12	Norvegjia	0	1
13	Italia	0	0
14	Spanja	1	0
15	Sllovenia	0	1
16	Kosova	1	0
17	Mali i Zi	0	1
	Totali	407	309

Burimi: DKM-ja.

Kërkesa për ripranimin e të miturve shqiptarë të pashoqëruar nga vende të BE-së dhe rajoni

Gjatë vitit 2024 është vërejtur një ulje e ndjeshme e numrit të kërkesave për ripranimin e të miturve të pashoqëruar në krahasim me vitin 2023. Në total janë trajtuar 12 kërkesa, nga 30 që ishin një vit më

parë. Të gjitha kërkesat e vitit 2024 janë pranuar, ndërsa asnjë rast nuk ka mbetur në procedurë apo i refuzuar.

Gjermania ka vazhduar të mbetet shteti me numrin më të lartë të kërkesave për këtë kategori, megjithëse me një rënie nga 17 në 11 kërkesa. Ndërsa Franca, Greqia, Italia dhe Kosova, të cilat kishin paraqitur kërkesa për të mitur të pashoqëruar gjatë vitit 2023, nuk kanë paraqitur asnjë kërkesë në vitin 2024. Suedia ka paraqitur vetëm një kërkesë në vitin 2024, nga dy që kishte një vit më parë. Fakti që të gjitha kërkesat e pranuar janë trajtuar pozitivisht tregon një qasje të konsoliduar dhe efikase nga autoritetet shqiptare në këtë proces delikat.

Më poshtë tabela 5.3.2 sipas shteteve

Nr.	Shteti	Kërkesa për ripranimin e të miturve të pashoqëruar					
		2023			2024		
		Total	Poz.	Proc.	Total	Poz.	Proc.
1	Gjermania	17	17	-	11	11	0
2	Franca	5	5	-	0	0	0
3	Suedia	2	2	-	1	1	0
4	Greqia	1	1	-	0	0	0
5	Italia	2	2	-	0	0	0
6	Kosova	3	3	-	0	0	0
	Totali	30	30	-	12	12	0

Burimi: DKM-ja.

Për trajtimin e kërkesave dhe ndjekjen e procedurave për kthim/ripranim të të miturve të pashoqëruar, bashkëpunuesi kryesor i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin është Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijës.

Operacionet e riatdhesimit nga Franca me eskortë shqiptare

Gjatë vitit **2024** janë kryer **6** operacione me eskortë shqiptare për riatdhesimin e shtetasve shqiptarë dhe janë kthyer **252** shtetas (përkatësisht nga Franca 232, Belgjika 2, Spanja 20). Ndërsa për vitin 2023 janë kryer 16 operacione dhe janë kthyer 526 shtetas shqiptarë.

Rezulton se gjatë vitit 2024 janë kryer 10 operacione më pak dhe deportuar 274 shtetas më pak se viti 2023.

Më poshtë tabela 5.3.3 sipas shteteve

Viti	2023	2024
Operacione	16	6
Shtetas të kthyer deportiv	526	252

Burimi: DKM-ja.

Kthimi vullnetar dhe kthimi vullnetar i asistuar për shtetas të vendeve të treta

Gjatë vitit 2024 janë trajtuar në total 24 kërkesa për shtetas të huaj, për kthim vullnetar dhe kthim të asistuar nga IOM-i. Ndërsa për vitin 2023 janë trajtuar 9 kërkesa. Rezulton se gjatë vitit 2024 janë trajtuar 15 kërkesa më shumë se viti 2023.

Më poshtë tabela 5.3.4

Viti	2023	2024
Kërkesa	9	24

Burimi: DKM-ja.

Azilkërkimi i pabazuar, i shtetasve shqiptarë në vendet e BE-së dhe zonën Schengen

Çështja e azilkërkuesve shqiptarë në vendet e Bashkimit Evropian është trajtuar me mjaft seriozitet nga qeveria shqiptare, veçanërisht nga Ministria e Brendshme. si institucioni lider për politikën e migracionit dhe azilit në vend.

Ministria e Brendshme ka marrë masat e duhura dhe ka pasur në vëmendje çështjen e azilkërkuesve shqiptarë në vendet e Bashkimit Evropian dhe zonën Schengen. Detyrimet e procesit të integritimit evropian dhe garantimi i zbatimit të duhur të regjimit pa viza, e bënë këtë çështje mjaft prioritare.

Sipas të dhënave të EUROSTAT-it gjatë vitit 2023 kemi pasur 6,980 aplikime për azil, për herë të parë, të shtetasve shqiptarë në vendet e BE-së dhe zonës Schengen, nga të cilat 2,660 në Francë.

Gjatë vitit 2024 kemi pasur 5,380 aplikime për azil për herë të parë, të shtetasve shqiptarë në vendet e BE-së dhe zonës Schengen (nga të cilat 1,635 në Francë). Kjo shifër bie me 22.9% krahasuar me vitin 2023.

Tabela 4.3.3: Shifrat krahasimore midis viteve

Azilkërkues shqiptarë në vendet BE dhe Schengen	
2023–2024	
Aplikime për herë të parë	
Viti	Numri
2023	6,980
2024	5,380
Diferenca	-1,600 (rënie me 1,600 aplikime) 22,9% më pak

Burimi: Drejtoria e Politikave të Migracionit, Azilit dhe Antitrafikut në Ministrinë e Brendshme.

Gjatë periudhës 2023–2024, numri i aplikimeve për herë të parë për azil nga shtetas shqiptarë në vendet kryesore të Bashkimit Evropian dhe hapësirës Schengen ka shënuar një rënie të përgjithshme, me përjashtime të kufizuara.

Rënia më e ndjeshme është regjistruar në Francë, ku aplikimet ranë nga 2,660 në vitin 2023 në 1,635 në vitin 2024, që përbën një ulje prej 38.5%. Ky ndryshim i theksuar vjen si rezultat i politikave më të rrepta të pranimit ose i mekanizmave më efektivë për parandalimin e migracionit të parregullt.

Edhe Gjermania ka shënuar një ulje të konsiderueshme, me aplikimet që zbritën nga 1,575 në 965, duke reflektuar një rënie prej 38.7%. Kjo prirje pasqyron, në një masë të madhe, qasjen gjithnjë e më selektive të këtij shteti përballë kërkesave për azil nga vende të konsideruara “të sigurta”, si Shqipëria.

Në të kundërt, Italia është i vetmi vend ku është regjistruar rritje e aplikimeve për azil, nga 1,490 në vitin 2023 në 1,675 në 2024, që përfaqëson një rritje prej 12.4%. Kjo rritje mund të lidhet me afërsinë gjeografike, rrugët tradicionale të migracionit apo me faktorë socio-ekonomikë që nxisin lëvizjen drejt Italisë.

Greqia, ndonëse me shifra më të ulëta në krahasim me vendet e tjera, ka shënuar një rritje modeste nga 530 në 550 aplikime, pra një rritje prej 3.8%, duke treguar një vazhdimësi të flukseve, për shkak të pranisë së mbylljes së rrugëve të mëparshme të emigracionit të parregullt dhe komuniteteve shqiptare ekzistuese në vend.

Ndërkohë, në Belgjikë dhe Holandë tendenca është lehtësisht në rënie. Në Belgjikë aplikimet ranë nga 255 në 235 (-7.8%), ndërsa në Holandë nga 30 në 25 (-16.7%). Këto shifra, megjithëse të vogla në total, pasqyrojnë një prirje të përgjithshme drejt uljes së kërkesave për azil në vendet që kanë adoptuar kritere më të rrepta për pranimin e kërkesave nga shtetas shqiptarë.

Në tërësi, këto të dhëna sugjerojnë një tkurje të ndjeshme të kërkesave për azil nga shtetas shqiptarë në disa nga destinacionet kryesore evropiane, çka mund të jetë rezultat i rritjes së ndërgjegjësimit për normat e pranimin të ulëta, forcimit të kontroleve, apo edhe zhvillimeve të brendshme socio-ekonomike në Shqipëri që ndikojnë në uljen e presionit migrator.

Tabela 5.3.5: Shifrat krahasimore midis viteve

Azilkërkues shqiptarë në vendet kryesore të BE-së dhe Schengen-it			
2023–2024			
Aplikime për herë të parë			
Shteti	Viti 2023	Viti 2024	Diferenca
Franca	2,660	1,635	-1,025
Gjermania	1,575	965	-610
Italia	1,490	1,675	+185
Greqia	530	550	+20
Belgjika	255	235	-20
Holanda	30	25	-5

Burimi: Drejtoria e Politikave të Migracionit, Azilit dhe Antitrafikut në Ministrinë e Brendshme

5.4 Statistikat

Ballkani Perëndimor vijon të mbetet i prekur nga zhvillimet në vendet e ndryshme të origjinës dhe tranzitit në Azinë Jug-Qendrore dhe Lindjen e Mesme, kjo edhe nga fakti që Turqia dhe Greqia janë kthyer në vende mund të presin dhe trajtojnë një numër të madh emigrantësh dhe refugjatësh.

Shqipëria gjithashtu ka rezultuar e prekur nga këto flukse migratore, që në përgjithësi tentojnë t'i përdorin vendet e këtij rajoni për të arritur më pas në vendet e Bashkimit Evropian.

Ministria e Brendshme me mbështetjen e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, ka zhvilluar vlerësime dhe analiza të rregullta për fenomenin e migracionit të parregullt që ka prekur vendin tonë gjatë viteve të fundit, shoqëruar me tendencë rritjeje të numrit të imigrantëve të parregullt të kapur në vendin tonë.

Gjatë vitit 2024, janë kapur në situatë të parregullt 1,540 imigrantë. Në krahasim me vitin 2023, kur janë kapur 6,630 të huaj imigrantë të parregullt, konstatojmë një rënie të shifrave me 76,7%.

Gjithsej, gjatë vitit 2024 janë kapur 1,469 meshkuj dhe 71 femra. Numri më i lartë përbëhet nga shtetasit sirianë, 336 persona; 3 fëmijë nën 17 vjeç. Pas tyre vijnë shtetasit pakistanezë me 287 persona, nga të cilët 4 nën 17 vjeç.

Lidhur me imigrantët e parregullt të kapur, vihet re që nga 1,540 në total, 1,254 janë kapur në kufi, 263 në territor dhe 23 në pikat kufitare.

Nga një total prej 1,540 imigrantë të kapur, 109 janë pajisur me urdhër dëbimi dhe mbyllur në qendrën e mbyllur në Karreç dhe 22 janë azilkërkues.

Shtetet me numrin më të lartë të imigrantëve të parregullt në Shqipëri janë Siria, Pakistani dhe Egjipti. Siria kryeson me 336 persona, duke përbërë rreth 21.8% të totalit të imigrantëve të parregullt. Ky numër pasqyron krizën e gjatë humanitare në rajonin e Lindjes së Mesme dhe fluksin e

vazhdueshëm të refugjatëve dhe emigrantëve që kërkojnë strehim jashtë vendit të tyre. Pakistani vjen i dyti me 287 persona, përkatësisht 18.6% të totalit, duke treguar një tendencë migrimi nga Azia Jugore, e ndikuar nga faktorë ekonomikë dhe socialë. Egjipti, gjithashtu, ka një përfaqësim të rëndësishëm me 187 imigrantë të parregullt, që përbëjnë afërsisht 12.1% të totalit.

Një tjetër shtet me numër relativisht të madh imigrantësh është Nepali me 140 persona, duke treguar lidhje migratore me Azinë Jugore dhe rritjen e flukseve migratore nga ky rajon drejt Shqipërisë. Afganistani dhe Irani, gjithashtu, kontribuojnë në numrin e imigrantëve të parregullt me 165 dhe 89 persona përkatësisht, duke reflektuar gjendjen e paqëndrueshmërisë politike dhe konfliktet në këto vende.

Në listën e shteteve me imigrantë të parregullt janë edhe vende të tjera si Bangladeshi (67), Somalia (54), Shteti i Palestinës (41), Irak (34), Maroko (29), India (26), Turqia (18) dhe vende të tjera me numër më të vogël imigrantësh që varion nga 1 deri në disa dhjetëra persona.

Nga kjo përmbledhje vërehet se Shqipëria përballet me një diversitet të madh shtetësish në numrin e imigrantëve të parregullt, me përqendrim kryesor në shtetasit nga Lindja e Mesme, Azia Jugore dhe Afrika Veri-Perëndimore. Kjo situatë është pasojë e pozitës gjeografike të Shqipërisë si një pikë tranziti drejt vendeve të Evropës Perëndimore, si dhe sfidave ekonomike dhe sociale që nxisin migrimin.

Zgjidhjet humane dhe mbështetja ndërkombëtare janë të rëndësishme për adresimin e shkaqeve themelore të migracionit të parregullt. Në përfundim, imigrantët e parregullt në Shqipëri përbëjnë një grup shumëllojshmëri prej 1,540 personash nga vende të ndryshme, kryesisht nga rajonet me konflikte, kriza ekonomike dhe sociale, që përbën një sfidë të vazhdueshme për politikat migratore dhe menaxhimin e kufijve në vend.

Tabela 5.4.1: Imigrantët e parregullt sipas shtetësisë 2024

Nr.	Shteti i origjinës	Numri
1	Afganistan	165
3	Algjeri	9
4	Bangladesh	67
7	Egjipt	187
8	Ekuador	2
9	Etiopi	1
10	Filipine	1
11	Guinea	2
13	Indi	26
14	Irak	34
17	Iran	89
18	Jemen	1
19	Kamerun	1
20	Kazakistan	1
21	Kinë	3
22	Kosovë	2
23	Kurdistan	3
24	Kuvajt	6

25	Liban	1
26	Libi	2
27	Maqedonia e Veriut	1
28	Maroko	29
29	Mauritani	1
30	Myanmar	1
31	Nepal	140
33	Nigeria	4
36	Pakistan	287
38	Shteti i Palestinës	41
39	Rusi (Federata Ruse)	1
41	Senegal	7
42	Sierra Leone	5
44	Siri	336
45	Somali	54
46	Sudan	9
47	Tunizi	2
48	Turkmenistan	1
50	Turqi	18
	Total	1,540

Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin.

Në vitin 2024, imigrantët e parregullt në Shqipëri shfaqin një diferencë të theksuar në përbërjen gjinore, ku meshkujt dominojnë numrin total të këtij grupi migrator. Nga 1,540 imigrantë të parregullt të regjistruar, 1,469 janë meshkuj, që përbën mbi 95% të totalit, ndërsa vetëm 71 persona janë femra, që është një përqindje shumë e vogël në krahasim me meshkujt.

Kur shikohet përhapja sipas shtetësisë, dominimi i meshkujve vërehet në pothuajse të gjitha shtetet e origjinës. Për shembull, nga Afganistani janë 165 imigrantë të parregullt, të gjithë meshkuj. Nga Siria, gjithashtu, numri i meshkujve është i madh, me 325 persona, ndërsa femrat janë vetëm 11. Nga Pakistani, prej 287 imigrantësh të parregullt, 285 janë meshkuj dhe vetëm 2 femra, duke ilustruar qartë prirjen e dominimit të meshkujve në këtë grup migrator.

Nga shumë vende të tjera të origjinës, numri i femrave të ardhura është shumë i vogël në krahasim me meshkujt, si Egjipti (181 meshkuj ndaj 6 femrave), Irani (83 meshkuj ndaj 6 femrave), Bangladeshi (64 meshkuj ndaj 3 femrave) dhe India (23 meshkuj ndaj 3 femrave). Ky model përsëritet në shumicën e vendeve të listuara, duke theksuar një dinamikë migrimi që dominohet nga pjesëmarrja e burrave në migracion të parregullt drejt Shqipërisë.

Një tjetër faktor që merret parasysh në të dhëna është përqindja e të miturve nën 17 vjeç, që në shumicën e rasteve është shumë e ulët. Vetëm 62 persona janë të mitur në total, ndërsa 1,478 janë mbi 17 vjeç. Kjo tregon se migrimi i parregullt në Shqipëri kryesisht përfshin të rriturit, me përqindje të ulët të migrimit të familjeve ose fëmijëve. Kjo përqindje e ulët e femrave dhe fëmijëve mund të reflektojë natyrën e migrimit të parregullt si një proces kryesisht individual dhe të orientuar drejt

kërkimit të punës, ku kryesisht meshkujt janë aktorët kryesorë. Gjithashtu, sfidat e sigurisë dhe kushtet e vështira të këtij lloji migrimi mund të pengojnë pjesëmarrjen e femrave dhe fëmijëve.

Në përgjithësi, përbërja gjinore e imigrantëve të parregullt në Shqipëri tregon një realitet të përqendruar në migrimin e burrave të rritur nga vende të ndryshme, që synojnë të përballojnë sfidat e migrimit dhe të krijojnë mundësi të reja jashtë vendit të tyre. Kjo përbën një sfidë të veçantë për politikatat publike dhe programet sociale në Shqipëri, të cilat duhet të adresojnë nevojat specifike të këtij grupi, duke marrë parasysh edhe përpjekjet për integrim, mbrojtje dhe ndihmë humanitare, veçanërisht për ato pak femra dhe fëmijë që janë pjesë e këtij fenomeni migrator.

Numri total i migrantëve të parregullt të kapur në Shqipëri ka pasur një rritje të ndjeshme pas vitit 2017, me kulmin në vitin 2020, ku janë regjistruar 13,042 raste. Pas kësaj pike, ka një rënie progresive, duke arritur në vetëm 1,540 raste në vitin 2024, që përbën një ulje prej 88.2% në krahasim me kulmin e vitit 2020.

Sirianët dhe afganët vazhdojnë të jenë kombësitë dominuese në mesin e migrantëve të kapur, por përqindja e tyre ka rënë në raport me vitet e mëparshme.

Rritja masive në vitet 2018–2020 përkon me ndryshime në rrugët ballkanike të migrimit dhe shtimin e presioneve nga Lindja e Mesme. Rënia që nga viti 2021 lidhet potencialisht me kontrolle më të forta kufitare, bashkëpunim ndërkombëtar dhe ndryshime në rrugët e migrimit.

Shqipëria përjetoi një krizë të fluksit të lartë të migrimit të parregullt në periudhën 2018–2020.

Viti 2024 shënon nivelin më të ulët të dekadës së fundit. Ka një ulje të migrantëve nga vendet e Lindjes së Mesme dhe Afrikës Veriore, një sinjal që kërkon më shumë analizë mbi origjinën e re të këtyre migrantëve. Kjo tendencë mund të tregojë efektshmërinë e politikave kontrolluese, por edhe zhvendosjen e rrugëve të migrimit në rajon.

Tabela 5.4.2: Të dhëna statistikore për imigrantët e parregullt në vite

Viti	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Numri	915	1,047	6,893	11,890	13,042	10,062	8,335	6,630	1,540
Afganë	259	53	147	541	1,893	1,377	1,324	1,610	165
Sirianë	326	360	3,089	3,294	6,224	5,366	3,030	1,305	336
Algjerianë	9	279	378	1,016	239	93	42	36	9
Irakenë	135	57	671	3,531	1,061	305	197	163	34
Marokenë	77	55	345	1,631	1,182	505	301	156	29
Të tjerë:	109	243	2,263	1,877	2,443	2,416	3,441	3,360	967

Burimi: Drejtoria e Politikave të Migracionit, Azilit dhe Antitrafikut, Ministria e Brendshme.

Shtetasit shqiptarë dhe të huaj që kthehen nga policitë e vendeve të tjera në kufi, u nënshtrohen procedurave të posaçme të pritjes, intervistimit dhe më pas përzgjedhjes. Një nga qëllimet e procesit të përzgjedhjes është edhe vlerësimi i vulnerabiliteteve dhe nevojave apo treguesve të trafikimit të qenieve njerëzore.

Referuar të dhënave të administruara nga Drejtoria e Politikave të Migracionit, Azilit dhe Antitrafikut në Ministrinë e Brendshme, për vitin 2024 janë identifikuar dhe referuar gjithsej 178 viktima/viktima të mundshme trafikimi.

Tabela 5.4.3 i referohet statusit, grup-moshës, gjinisë dhe kombësisë së viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit për vitin 2023 dhe 2024.

Tabela 5.4.3: Viktima trafikimi/viktima të mundshme trafikimi (2023–2024)

ITI		2023	2024
Statusi	Viktima trafikimi	1	15
	Viktima të mundshme trafikimi	164	163
Mosha	Të rritur	56	82
	Fëmijë	109	96
Gjinia	M	50	65
	F	115	113
Shtetësia	Shqiptarë	161	126
	Të huaj	4	52

Burimi: Sektori Antitrafik, Ministria e Brendshme.

6. KTHIMI, RIPRANIMI DHE RIINTEGRIMI

6.1 Autoritetet përgjegjëse

Ministria e Brendshme, nëpërmjet strukturës së Departamentit për Kufirin dhe Migracionin në Policinë e Shtetit, dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, nëpërmjet strukturës së çështjeve konsullore kanë përgjegjësinë kryesore për hartimin e politikave për kthimin/ripranimin e të huajve me qëndrim të paligjshëm në Shqipëri, si dhe për implementimin e instrumenteve juridike dypalëshe dhe shumëpalëshe (marrëveshje rripranimi), me qëllim ndjekjen dhe kryerjen e procedurave të kthimit/ripranimit të shtetasve të saj, kthimet vullnetare, zbatimi i të cilave asistohet kryesisht nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin në Shqipëri (IOM).

Zbatimi i kthimeve/ripranimeve mbështetet nga oficerët e kontaktit dhe stafet konsullore shqiptare jashtë vendit, që marrin pjesë në praktikat e bashkëpunimit me autoritetet e vendeve përkatëse për të mbështetur kthimin e personave. Si rezultat i refuzimit të azilkërkimit për shtetas shqiptarë në disa shtete të BE-së, kthimet pas përfundimit të procesit të azilkërkimit, nga një natyrë deportuese janë konvertuar në kthime vullnetare. Bisedimet dypalëshe i kanë paraprirë fenomenit të kthimit vullnetar kryesisht nëpërmjet fluturimeve speciale nga shtete të BE-së, si: Gjermania, Franca, Mbretëria e Bashkuar, Suedia, etj. Pjesa më e madhe e fluturimeve të kësaj natyre koordinohen nga FRONTEX-i (Agjencia Evropiane e Menaxhimit të Kufijve dhe Rojës Bregdetare).

Për sa i përket procesit të riintegritimit janë të përfshira shumë institucione të nivelit qendror dhe vendor që merren me zbatimin e politikave për riintegritimin e personave të riatdhesuar.

Procesi i riintegritimit të personave të riatdhesuar në Shqipëri përfshin një gamë të gjerë institucionesh në nivel qendror dhe vendor, të cilat bashkëpunojnë për zbatimin e politikave gjithëpërfshirëse dhe efektive në këtë fushë. Në nivelin qendror, aktorët kryesorë janë: Ministria e Brendshme, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit dhe Sportit, si dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Secila prej këtyre institucioneve kontribuon në zbatimin e masave për riintegritimin, sipas fushës së kompetencës dhe në përputhje me angazhimet ligjore dhe politike.

Në veçanti, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme luan një rol kyç në koordinimin e veprimeve me strukturat e Ministrisë së Brendshme, duke siguruar zbatimin e marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale për rripranimin e shtetasve shqiptarë të kthyer nga vendet e tjera. Ky bashkërendim është thelbësor për garantimin e një procesi të strukturuar dhe të qëndrueshëm riintegritimi, që mbështet rikthimin dinjitoz dhe përfshirjen sociale të personave të riatdhesuar.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Drejtorisë së Politikave të Përkujdesjes Sociale dhe Shërbimeve Sociale të Integruara është përgjegjëse për të kontribuar në sigurimin e aksesit

në kujdes shëndetësor dhe mbrojtjes, dhe përfshirjes sociale dhe përkujdesjes sociale e shanseve të barabarta, në zbatim legjislationit në fuqi. Ajo mbështet integrimin e emigrantëve të kthyer dhe migrantëve të brendshëm në sistemin shëndetësor, të sigurimeve shëndetësore dhe mbrojtjes sociale.

Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) monitoron dhe analizon ndikimin e migracionit në shëndetin publik, duke ndjekur sëmundjet infektive dhe faktorët e riskut. Ai zbaton programe për vaksinimin dhe depistimin për migrantët.

Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (OSHKSH) është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve shëndetësore parësore dhe spitalore në të gjithë vendin, duke përfshirë edhe migrantët. Ai siguron akses në kujdes bazuar në parimet e universalitetit dhe ndihmon në zbatimin e masave praktike për përfshirjen e migrantëve në sistemin shëndetësor.

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) administron sigurimet shëndetësore dhe mbulimin financiar të kujdesit shëndetësor, duke luajtur një rol të rëndësishëm në përcaktimin e kriterëve të përfitimit për migrantët dhe personat e kthyer, si dhe në sigurimin e barazisë në financimin e shërbimeve shëndetësore për popullatën në lëvizje.

Inspektorati i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, është institucion në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, përgjegjës për kontrollin dhe verifikimin e zbatimit të standardeve të shërbimeve të kujdesit shoqëror në përputhje me standardet dhe kërkesat e ligjit “Për shërbimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Shërbimi Social Shtetëror është institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përgjegjës për zbatimin e politikave të ministrisë përgjegjëse për çështjet e ndihmës ekonomike, të aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve është institucioni përgjegjës për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, në zbatim të politikave kombëtare për mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna.

Njësitë e qeverisjes vendore. Sipas Reformës Territoriale të miratuar nëpërmjet ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” dhe bazuar në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, siguri dhe funksionimi i shërbimeve shoqërore për kategoritë në nevojë, përfshirë të moshuarit, është përgjegjësi e njërive të vetëqeverisjes vendore, përkatësisht për: krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale komunitare, në nivel lokal, ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore, krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Drejtoritë e Shërbimeve Sociale në nivel vendor kanë përgjegjësi për planifikimin, administrimin dhe ofrimin e asistencës sociale dhe shërbimeve sociale në nivel lokal. Njësitë e vlerësimit dhe referimit të nevojave (NJVRN), njësitë e mbrojtjes së fëmijëve (NJMF), koordinatorët lokal përgjegjës për dhunën në familje dhe ndaj grave dhe punonjës të tjerë të shërbimeve sociale janë përgjegjës për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale komunitare, në nivel lokal, ndërtimin dhe administrimin e qendrave komunitare për ofrimin e shërbimeve sociale vendore, si dhe krijimin e shërbimeve dhe tipologjive të ndryshme të shërbimit për t’ju përgjigjur nevojave të grupeve të ndryshme në kontekstin lokal.

Ministria e Arsimit dhe Sportit është përgjegjëse për të kontribuar në integrimin e shtetasve të huaj dhe shqiptarëve të kthyer në Shqipëri në fushën e arsimit, kulturës dhe shkencës.

6.2 Kuadri ligjor

Në fushën e trajtimit të migracionit të parregullt duke siguruar kthimin efikas dhe të qëndrueshëm, për Shqipërinë vazhdon të jetë prioritet në veçanti kthimi vullnetar. Në përputhje me Direktivën e

Kthimit, politika e kthimit në Shqipëri mbështet kthimin vullnetar të personave, të cilët janë subjekt i një detyrimi për t'u larguar nga territori i Shqipërisë.

Kuadri ligjor për të huajt, konkretisht ligji nr. 79/2021, "Për të huajt", si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, veçanërisht udhëzimi i ministrit të Brendshëm nr. 174, datë 12.9.2022, "Mbi procedurat e trajtimit të të huajve me qëndrim të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë", rregullon çështje dhe politika mbi:

- kthimin, ripranimet dhe riintegrimin e qëndrueshëm të të kthyerve;
- largimin, dëbimin, ndalimin;
- mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të imigrantëve dhe mbrojtjen e të dhënave personale;
- masat ndëshkimore dhe ankimimin;
- integrimin e imigrantëve, etj.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nëpërmjet drejtorive në përbërje të saj dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA), ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin përkatës dhe është përgjegjëse për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer, konkretisht në:

- fushën e zhvillimit dhe monitorimit të politikave shtetërore për emigrimin për motive punësimi dhe çështjet e lidhura me të, si: punësimin, arsimin dhe formimin profesional dhe marrëdhëniet e punës;

- përfshirjen e kategorisë së shtetasve shqiptarë të kthyer me probleme ekonomike në grupet e veçanta të punëkërkesve të papunë, që përfitojnë nga programet e nxitjes së punësimit;

- identifikimin e nevojave ekzistuese për formimin profesional të shtetasve shqiptarë të kthyer;

- ofrimin e trajnimeve falas në drejtoritë rajonale të formimit profesional publik të shtetasve shqiptarë të kthyer me probleme ekonomike;

- ngritjen dhe funksionimin e Sporteleve të Migracionit në të gjitha drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të punësimit;

- bashkërendimin e punës për zbatimin e politikave në fushën e riintegrit të emigrantëve të kthyer, në nivelin qendror dhe nivelin vendor.

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA), në bashkëpunim me drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të punësimit, përfaqësojnë shtyllat kryesore të mekanizmit vendor të mbështetjes për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer. Këto struktura shërbejnë si pikë kyçe në nivel vendor për të mbledhur të dhëna të hollësishme për shtetasit shqiptarë të kthyer, të cilët paraqiten vullnetarisht pranë tyre.

Zyrat e punësimit kryejnë funksionet e mëposhtme:

i. intervistimin e shtetasve shqiptarë të kthyer që paraqiten vullnetarisht në sportel;

ii. dhënien e informacionit për shërbimet publike dhe ato private, në përputhje me nevojat e identifikuar (kur ekzistojnë);

iii. referimin tek shërbimet publike dhe ato private (kur ekzistojnë), si dhe projekte specifike të shoqërisë civile në përputhje me nevojat e tyre;

iv. mbështetjen për punësimin e emigrantëve të kthyer, nëpërmjet përfshirjes në programet e ndërmjetësimit në punë, programeve të nxitjes së punësimit, projekte për vetëpunësimin;

v. identifikimin e nevojave për formim profesional, duke identifikuar aftësitë që posedojnë, nevojat për kualifikim shtesë, mundësitë për trajnime profesionale mbi përmirësimin e aftësive të punësueshme.

6.3 Statistika

Statistika mbi shtetasit e huaj të kthyer

Gjatë vitit 2024, numri i imigrantëve të parregullt të kapur në territorin shqiptar shënoi një rënie të ndjeshme në krahasim me vitin 2023, duke reflektuar një ndryshim të rëndësishëm në dinamikën e

migracionit të paligjshëm në vend. Sipas të dhënave zyrtare, në total u kapën 1,540 shtetas të huaj në situatë migrimi të parregullt, nga të cilët 1,394 ishin individë të kapur për herë të parë, ndërsa 146 persona rezultuan si përsëritës të kapjes për herë të dytë ose më shumë. Kjo shifër përbën një ulje prej 77% në krahasim me vitin 2023, kur u evidentuan 6,630 imigrantë të parregullt, prej të cilëve 4,781 ishin të kapur për herë të parë dhe 1,849 përsëritës.

Ky trend në rënie mund të jetë pasojë e një sërë faktorësh, duke përfshirë përmirësimin e masave kufitare dhe të kontrollit të migracionit, bashkëpunimin më të ngushtë ndërkombëtar, si dhe ndryshime në rrjedhat migratore dhe në vendet e origjinës ose tranzitit. Ulja e theksuar prej 5,090 personash të kapur më pak, tregon një sukses të mundshëm të përpjekjeve për parandalimin dhe menaxhimin e migracionit të parregullt në Shqipëri.

Analiza e vendndodhjes së kapjeve tregon se pjesa më e madhe e imigrantëve të kapur, konkretisht 1,254 persona, janë konstatuar në zonat kufitare, duke evidentuar kështu rolin kryesor të kufijve në kontrollin e flukseve migratore. Ndërkohë, 263 të huaj janë kapur në territorin e brendshëm të vendit, ndërsa 23 janë evidentuar në pikat kufitare, që paraqet një numër më të vogël dhe sugjeron se pjesa më e madhe e kontrollit dhe ndalimit kryhet në kufij dhe jo brenda territorit.

Nga aspekti i masave administrative dhe ligjore që kanë ndjekur kapjen e këtyre personave, vërehet se nga totali i imigrantëve të parregullt të kapur, 82 janë pajisur me urdhër dëbimi dhe janë mbyllur në qendrën e mbyllur në Karreç, që tregon se rreth 5.3% e të kapurve kanë kaluar në fazën e detentimit si masë e përkohshme para largimit. Një pjesë tjetër prej 63 personash rezultojnë azilkërkues, çka ilustron faktin se edhe në mes të imigrantëve të parregullt ka një grup që kërkon mbrojtje ndërkombëtare dhe trajtim sipas rregullave për azilin. Gjithashtu, shumica dërrmuese, plot 1,395 persona, janë pajisur me urdhër largimi vullnetar, që nënkupton se këta individë janë të detyruar të largohen nga territori i Shqipërisë në mënyrë jodetyruese, si pjesë e procedurave të ripranimit drejt vendeve nga të cilat kanë tranzituar.

Kjo strukturë e masave pas kapjes tregon qartë një përpjekje të mirëorganizuar institucionale për të menaxhuar migracionin e parregullt në mënyrë sistematike dhe të bazuar në ligj, duke respektuar parimet e drejtësisë dhe të procedurave administrative.

Në përmbledhje, të dhënat për vitin 2024 dëshmojnë për një reduktim të dukshëm të imigrantëve të parregullt të kapur në Shqipëri krahasuar me vitin e mëparshëm, duke reflektuar ndryshime pozitive në menaxhimin e migracionit. Megjithatë, prania e një numri të konsiderueshëm të personave të kapur dhe masave të ndjekura ndaj tyre tregon se migracioni i parregullt mbetet një sfidë komplekse që kërkon monitorim të vazhdueshëm dhe politika të koordinuara në nivel kombëtar dhe rajonal.

Shqiptarët e kthyer

Në vitet 2023 dhe 2024, Shqipëria ka regjistruar një numër të konsiderueshëm kthimesh të shtetasve të saj nga vendet e Bashkimit Evropian dhe vendet fqinje, kryesisht përmes operacioneve të përbashkëta të riatdhesimit. Kthimet e këtyre shtetasve shqiptarë, shpesh të deportuar ose të kthyer për arsye ligjore, pasqyrojnë një tendencë të qëndrueshme por në ulje në dy vitet e fundit.

Në vitin 2023, numri i shtetasve shqiptarë të kthyer në Shqipëri ishte 8,224 persona. Ky numër pësoi një rënie në vitin 2024, duke u ulur në 7,901 persona, që përbën një ulje prej rreth 4% në krahasim me vitin paraardhës. Kjo tendencë në ulje mund të lidhet me ndryshimet në politikat migratore të vendeve pritëse, përmirësimin e kontrolleve kufitare ose edhe me reduktimin e flukseve të migracionit nga Shqipëria drejt vendeve të BE-së dhe zonës *Schengen*.

Një aspekt i rëndësishëm i këtyre kthimeve është përbërja gjinore e personave të kthyer. Nga 7,901 shtetas shqiptarë të kthyer në vitin 2024, 7,521 ishin meshkuj, ndërsa vetëm 380 femra. Kjo tregon se përqindja e meshkujve të kthyer është jashtëzakonisht e lartë, duke përbërë rreth 95% të totalit, ndërsa femrat përbëjnë vetëm 5%. Kjo përputhet me tendencat globale të migracionit, ku burrat janë më të përfshirë në migrim, sidomos në ato lloje të migracionit që përfshijnë kthime ose deportime.

Shifrat tregojnë, gjithashtu, se shumica e kthimeve janë rezultat i bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe vendeve të tjera për operacione të përbashkëta riatdhesimi, duke reflektuar një proces të strukturuar dhe të organizuar për menaxhimin e migracionit dhe kontrollin e kufijve. Ky bashkëpunim është i rëndësishëm për sigurinë dhe stabilitetin e rajonit, por, gjithashtu, për trajtimin dinjitoz të personave të kthyer.

Në një dimension tjetër, sipas të dhënave të EUROSTAT-it, në vitin 2023 janë regjistruar 7,015 aplikime të para për azil nga shtetas shqiptarë në vendet e BE-së dhe zonën *Schengen*. Ky numër paraqet një rënie të ndjeshme në krahasim me vitin 2022, kur ishin regjistruar 10,745 aplikime të para për azil nga shqiptarët, që është një ulje prej rreth 35%. Kjo tregon një tendencë të qartë zvogëlimi të kërkesave për azil nga shtetasit shqiptarë në këto vende, e cila mund të lidhet me përmirësimin e kushteve socio-ekonomike në Shqipëri, ndryshimet në politikat e migracionit në vendet pritëse, apo edhe me rritjen e vetëdijes për procedurat ligjore të migracionit.

Në këtë kontekst, ulja e aplikimeve për azil dhe rënia e numrit të kthimeve mund të jenë shenja pozitive që tregojnë një stabilizim gradual të situatës migratore shqiptare. Megjithatë, numri i konsiderueshëm i personave të kthyer tregon se migracioni i parregullt dhe kërkesat për azil mbeten sfida reale për Shqipërinë dhe vendet pritëse.

Në përmbledhje, viti 2024 karakterizohet nga një reduktim modest i kthimeve të shtetasve shqiptarë në vend krahasuar me vitin 2023, me dominim të qartë të meshkujve në këtë proces. Njëkohësisht, ka një rënie të dukshme të aplikimeve për azil nga shqiptarët në vendet e BE-së, duke treguar për një ndryshim gradual në dinamikën migratore. Këto të dhëna janë thelbësore për hartimin e politikave të ardhshme që synojnë menaxhimin e migracionit, përmirësimin e kushteve të riintegritimit të të kthyerve dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e migracionit.

Tabela 6.3.1: *Shtetas shqiptarë të kthyer për vitet 2023 dhe 2024*

Viti	Numri i të kthyerve
2023	8,224
2024	7,901

Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin.

7. INTEGRIMI

7.1 Autoritetet përgjegjëse

Në Shqipëri, Ministria e Brendshme ka përgjegjësinë kryesore për çështjet e migracionit dhe integritimit, duke shërbyer si autoriteti qendror që drejton dhe mbikëqyr politikat kombëtare në këtë fushë. Megjithatë, në nivel institucional, mungon një sistem i specializuar dhe i mirëstrukturuar për koordinimin ndërsektorial të integritimit, çka përbën një sfidë për zbatimin koherent dhe të unifikuar të politikave të integritimit.

Në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të integritimit social të të huajve, janë të angazhuara disa institucione në varësi të fushës së tyre të kompetencës.

Këto përfshijnë:

- ministrinë përgjegjëse për punën, që ka një rol kyç në përfshirjen e të huajve në tregun e punës dhe në sigurimin e mundësive të barabarta për punësim;
- ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, që mbulon qasjen në shërbimet sociale dhe mbrojtjen sociale;
- ministrinë përgjegjëse për arsimin, sportin, rininë dhe kërkimin shkencor, e cila siguron akses në arsim dhe nxit pjesëmarrjen sociale dhe kulturore;
- ministrinë përgjegjëse për turizmin; dhe

- ministrinë përgjegjëse për kulturën, që luajnë rol në lehtësimin e integritit përmes aktiviteteve ndërkulturore dhe promovimit të përfshirjes komunitare.

Fitimi i shtetësisë shqiptare bëhet me dekret të Presidentit të Republikës, por është Ministria e Brendshme, autoriteti përgjegjës për zbatimin e politikave dhe procedurave në çështjet që ndërlidhen me shtetësinë në Republikën e Shqipërisë. Në këtë kuadër janë strukturat në Policinë e Shtetit dhe Sektori i Pranimit dhe Shqyrtimit të Dokumentacionit në Drejtorinë e Politikave të Shtetësisë në Ministrinë e Brendshme që pranojnë aplikimin, kontrollojnë, verifikojnë dhe vendosin për t'ia kaluar këtë kërkesë Presidentit për dekretim.

7.2 Kuadri ligjor

Ligji nr. 79/2021, “Për të huajt”, përcakton rregullat për hyrjen, qëndrimin, punësimin dhe integrimin e të huajve në territorin e Shqipërisë. Ligji parashikon bashkëpunim ndërinstitucional për integrimin, duke përfshirë ministrinë, pushtetin vendor, organizatat e shoqërisë civile dhe aktorë të tjerë.

Ligji parashikon se të huajt me qëndrim të rregullt afatgjatë kanë të drejtë të përfitojnë nga shërbime integrimi, si: mësimi i gjuhës shqipe, orientimi kulturor dhe ligjor, qasje në arsim dhe shërbime shëndetësore dhe përfshirje në tregun e punës. Qasja në edukim dhe trajnim profesional për të huajt që kanë leje qëndrimi, në përputhje me të njëjtat kushte si shtetasit shqiptarë.

Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024–2030, e miratuar nga qeveria shqiptare dhe e botuar në Fletoren Zyrtare, më 11 maj 2024, ka hyrë në fuqi dhe përcakton politikat dhe masat për menaxhimin e migracionit në Shqipëri deri në vitin 2030. Kjo strategji synon të optimizojë ndikimin e migracionit në zhvillimin social-ekonomik të vendit, duke promovuar migrimin e rregullt dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve, azilkërkuesve dhe refugjatëve. Dokumenti parashikon mbështetje për të huajt, nëpërmjet sigurimit të kushteve për integrimin e tyre në tregun e punës dhe shoqërinë shqiptare, duke përfshirë informimin mbi mundësitë dhe procedurat e migrimit. Gjithashtu, dokumenti parashikon masa të veçanta për integrimin e të huajve, si: Ofrimi i informacionit për mundësitë e migrimit dhe procedurat për të huajt që dëshirojnë të punojnë në Shqipëri; Sigurimi i mundësive për punësim dhe arsim profesional për të huajt, për t'i ndihmuar ata të integrohen në tregun e punës dhe shoqërinë shqiptare; Koordinimi me organizata ndërkombëtare, shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë për të siguruar mbështetje dhe integrim të suksesshëm të të huajve.

Mbështetja për integrimin, përveç personave që vijnë nga trevat shqiptolëse, është e nevojshme për emigrantët që vijnë nga vendet e treta të cilët nuk flasin shqip, për përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare (refugjatët dhe përfituesit e mbrojtjes plotësuese), si dhe të personave pa shtetësi. Shtetasit e huaj që jetojnë në Shqipëri (përfitues të mbrojtjes ndërkombëtare, qytetarët e BE-së, të vendeve të treta) kanë të drejtë për një gamë të gjerë shërbimesh, por këto janë të fragmentuara, në varësi të motivit të qëndrimit.

Fitimi i shtetësisë shqiptare rregullohet nëpërmjet ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”. Në zbatim të dispozitave të këtij ligji, që përcaktojnë rregullat dhe kriteret për fitimin, lënien dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare, kanë dalë në zbatim disa akte nënligjore të cilat përcaktojnë rregullat, afatet, dokumentet dhe autoritetet kompetente për shqyrtimin e këtyre kërkesave.

7.3 Statistika

Një pjesë e vogël e të huajve me qëndrim të rregullt në Shqipëri kërkojnë shtetësinë shqiptare.

Të dhënat e Drejtorisë së Politikave të Shtetësisë tregojnë ndryshime domethënëse në numrin e aplikimeve për shtetësi shqiptare gjatë viteve 2022–2024, për tre kategori kryesore: fitim shtetësie, lënie shtetësie dhe rifitim shtetësie.

Në vitin 2022, numri i personave që fituan shtetësinë shqiptare ishte 1,527. Ky numër u ul në 1,368 në vitin 2023, që përbën një rënie prej rreth 10.4%. Në vitin 2024, ky numër ra edhe më tej në 919,

duke shënuar një rënie të fortë prej 32.8% krahasuar me vitin 2023. Kjo tendencë tregon një ulje të dukshme të aplikimeve të suksesshme për shtetësi gjatë periudhës.

Numri i personave që kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare ka pasur një rritje nga 721 në vitin 2022 në 866 në vitin 2023, një rritje prej rreth 20.1%. Por në vitin 2024, ky numër u ul ndjeshëm në 472, duke regjistruar një rënie prej 45.5% krahasuar me vitin 2023. Kjo luhet mund të reflektojë ndryshime në faktorë personalë apo ligjorë që ndikojnë në vendimin për të hequr dorë nga shtetësia.

Rifitimi i shtetësisë shqiptare është shënuar me një trend në rritje gjatë këtyre viteve. Nga vetëm 50 raste në vitin 2022, ky numër u rrit në 92 në vitin 2023, që përbën një rritje prej 84%, dhe më pas u dyfishua pothuajse në 217 raste në vitin 2024, që është një rritje prej 135.9% krahasuar me vitin 2023. Ky trend tregon një interes të shtuar për rifitim të shtetësisë.

Në tabelën në vijim pasqyrohen të dhënat mbi aplikimet për shtetësi shqiptare gjatë viteve të fundit.

Tabela 7.3.1: Aplikime për marrjen e shtetësisë shqiptare (2022-2024)

	2022	2023	2024
Fitim shtetësie	1,527	1,368	919
Lënie shtetësie	721	866	472
Rifitim shtetësie	50	92	217

Burimi: Drejtoria e Politikave të Shtetësisë.

8. MIGRACIONI DHE ZHVILLIMI

8.1 Autoritetet përgjegjëse

Ministria e Brendshme ka përgjegjësinë kryesore për menaxhimin e qeverisjes së migracionit apo çështjeve të lidhura me këtë fushë, ndërsa Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe Agjencia Kombëtare e Diasporës janë institucionet që kanë misionin të përfaqësojnë e nxisin politikën e bashkëpunimit dhe të ndërveprimit me të gjithë shqiptarët, duke nxitur e fuqizuar bashkëpunimin në të gjitha fushat me shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe shtetet ku ata banojnë, në bashkëpunim me institucionet përkatëse.

Nisur nga fakti se zhvillimi ekonomik i vendit është i lidhur drejtpërdrejtë me proceset migratore, një sërë ministriash, si: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit dhe Sportit, etj., sipas fushës së veprimtarisë së tyre përfshijnë hartimin e politikave dhe strategjive, të cilat direkt apo indirekt rregullojnë çështje që kanë të bëjnë me migracionin dhe zhvillimin.

8.2 Kuadri ligjor

Qëllimi i përbashkët i autoriteteve përgjegjëse në fushën e migracionit dhe zhvillimit të vendit, është krijimi i një klime të favorshme për promovimin dhe tërheqjen e investimeve të huaja dhe nga diaspora. Në këtë kuadër, dërgesat në para të emigrantëve konsiderohen si element përbërës i investimeve të huaja direkte. Gjithashtu, një nga objektivat e qeverisë shqiptare është zhvillimi i zonave të lira ekonomike ose zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik.

Dokumenti Politik për Angazhimin e Komuniteteve Shqiptare Jashtë Vendit, hartuar nga qeveria shqiptare me mbështetjen teknike dhe financiare të IOM-it, në periudhën 2015–2016, ishte formalizimi i parë i një kuadri politikash për vendosjen e një marrëdhënieje me përfitim të ndërsjellë ndërmjet Shqipërisë dhe komuniteteve të saj jashtë vendit.

Strategjia Kombëtare për Diasporën ka qëllim të përfshijë dhe fuqizojë pjesëmarrjen e diasporës dhe migrantëve si faktor të zhvillimit të Shqipërisë, nëpërmjet kapitaleve të dijeve dhe vlerave që ata zotërojnë. Strategjia ka si objektiv kryesor krijimin e një kuadri të plotë politik për diasporën dhe të qenit një instrument i dobishëm në ndihmë të qeverisë dhe aktorëve të tjerë, për të përmirësuar dhe fuqizuar bashkëpunimin me diasporën.

Ministria e Financave, MEKI dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe në veçanti ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, në kuadër të politikave zhvillimore, si dhe të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike”, kanë rol mbështetës dhe kontribuues në mënyrë indirekte në fushën e migracionit dhe zhvillimit.

Diaspora

Diaspora shqiptare përbëhet aktualisht nga pesë grupe kryesore:

- i. emigrantët ekonomikë;
- ii. pjesëtarët e familjeve të emigrantëve ekonomikë;
- iii. studentët;
- iv. azilkërkuesit dhe refugjatët;
- v. fëmijët e pashoqëruar.

Grupet më të mëdha të diasporës përbëhen nga emigrantët ekonomikë, pjesëtarët e familjeve të emigrantëve ekonomikë dhe studentët. Ndërkohë, megjithëse me ritme më të ulëta, gjatë vitit 2023 vijoi fluksi i azilkërkuesve drejt vendeve të BE-së, ku numrin më të madh e zënë azilkërkuesit drejt Francës.

Largimet e popullsisë shqiptare kanë ardhur në rritje gjatë viteve dhe zgjerimi i mundshëm i BE-së në Ballkanin Perëndimor, mund të nxisë flukse të mëtejshme migratore nga Shqipëria. Numri i lartë i emigrantëve ka prodhuar, gjithashtu, flukse të konsiderueshme të remitancave në vite. Këto flukse përbëjnë një burim të jashtëzakonshëm dhe të pazëvendësueshëm financimi për ekonominë vendase dhe shpesh kanë treguar se janë në gjendje t’u rezistojnë edhe situatave të krizave ekonomike. Pritjet janë për kontribute edhe më të larta në të ardhmen, ndikuar edhe nga parashikimet për përmirësim të aktivitetit ekonomik në vendet pritëse.

9. AZILI DHE MBROJTJA NDËRKOMBËTARE

9.1 Autoritetet përgjegjëse

Me qëllim harmonizimin e legjislacionit vendas me direktivat e BE-së, Republika e Shqipërisë ka hartuar ligjin nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, i cili parashikon kushtet dhe procedurat për dhënien dhe heqjen e statusit të refugjatit, mbrojtjes plotësuese dhe mbrojtjes së përkohshme në Republikën e Shqipërisë, të drejtat dhe detyrimet e azilkërkuesve, refugjatëve e personave nën mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese, përmbajtjen e statusit të refugjatit dhe mbrojtjes plotësuese, të drejtën për bashkim familjar, si dhe përcaktimin e kushteve për integrimin e refugjatëve e të personave nën mbrojtje plotësuese në Republikën e Shqipërisë.

Ligji për azilin afron Shqipërinë me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin e BE-së për çështjen e rëndësishme të menaxhimit të duhur të refugjatëve dhe migrantëve që hyjnë në territorin shqiptar dhe garanton që personat që kërkojnë azil të kenë qasje në procedurën e azilit, rregullon kushtet për përpunimin e kërkesave të tyre dhe ofron garanci shtesë për trajtimin e kategorive të ndjeshme midis azilkërkuesve, siç janë të miturit e pashoqëruar.

Komisioni Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët

Legjislacioni për azilin parashikon edhe hallkën administrative të ankimit ndaj vendimeve të Autoritetit Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët që përbën një garanci më tepër për azilkërkuesit dhe refugjatët. Në ligjin përkatës parashikohet Komisioni Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët si autoriteti i vetëm kompetent vendimmarrës për ankimet kundër vendimeve të Autoritetit Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët. Në vitin 2021 u miratua VKM-ja nr. 669, datë 10.11.2021, “Për kriteret e emërimit, arsyet e lirimit ose shkarkimit, si dhe shpërblimin e anëtarëve të Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët”.

Standardet e pritjes

Bazuar në ligjin nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, është miratuar VKM-ja nr. 630, datë 27.10.2021, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Pritjes së Azilit”. Misioni i

Qendrës është respektimi i legjislacionit vendas dhe ndërkombëtar të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, me fokus ato të azilkërkuesve dhe refugjatëve të akomoduar dhe përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të shërbimeve.

Qendra Pritëse për Azil (QPA, ofron akomodim dhe shërbime riintegruese për azilkërkuesit, si në të gjitha vendet e BE-së. QPA-ja është një qendër e hapur dhe ka garantuar një kapacitet deri në 250 persona. Kjo qendër ka gjithsej 15 punonjës duke përfshirë: një mjek, një punonjës social, një psikolog dhe ka një mjedis më të gjerë. Qendra, gjithashtu, ofron ambiente të përshtatshme për fëmijë, biblioteka, internet kafe dhe ambiente sportive.

Qendra e Pritjes për Azil akomodon azilkërkuesit duke marrë parasysh nevojat e tyre specifike, si dhe në varësi të kapacitetit të dhomave, duke e pajisur çdo dhomë me kushtet elementare të jetesës. Për kategori të ndryshme azilkërkuesish merren parasysh specifikat përkatëse që vlerësojnë nevojat e këtyre kategorive.

Azilkërkuesit qëndrojnë në këtë qendër deri në përfundimin e procedurave të azilit dhe në rast të vendimeve negative lejohen sërish të qëndrojnë në këto ambiente deri në përfundimin e procedurave të ankimimit.

9.2 Statistika

Gjatë periudhës 2022–2024, numri i azilkërkuesve në Shqipëri ka pasur ndryshime të dukshme, si në volum ashtu edhe në përbërjen sipas vendit të origjinës. Në vitin 2022, u regjistruan gjithsej 125 azilkërkues, një numër që pothuajse u dyfishua në vitin 2023, duke arritur në 261 persona, për t'u ulur sërish në 104 azilkërkues në vitin 2024.

Vendet me numrin më të madh të azilkërkuesve gjatë kësaj periudhe ishin Afganistani, Siria dhe Iraku. Afganistanasit përbënin rreth 29% të totalit në 2022 dhe u rritën ndjeshëm në më shumë se 60% të azilkërkuesve në vitin 2023. Megjithatë, në 2024 pati një ulje të konsiderueshme të tyre, duke përbërë përsëri rreth 32% të totalit, por duke mbetur grupi më i madh i azilkërkuesve. Siria, e cila kishte vetëm 5 azilkërkues në 2022, pësoi një rritje të ndjeshme në 2023, me 38 raste, ndërsa në 2024 ky numër ra në 17, që përbën një ulje, por që përsëri tregon prezencë të vazhdueshme.

Iraku, gjithashtu, shfaqti një rritje në 2023, por më të moderuar krahasuar me Afganistanin dhe Sirinë, dhe më pas një rënie në 2024. Përveç këtyre vendeve, Ukraina pati një prani të rëndësishme në 2022 me 27 azilkërkues, por numri i tyre ra ndjeshëm në vitet pasuese, duke reflektuar ndryshime në lëvizjet migratore.

Disa shtete të tjera, si Somalia, shënuan rritje të përkohshme në vitin 2023, por nuk patën azilkërkues në vitin 2024. Në të kundërt, në vitin 2024 shfaqen vende të reja me numër të vogël azilkërkuesish, si: Argjentina, Armeni, Kameruni dhe Kazakistani, që tregojnë një diversifikim të origjinës së azilkërkuesve, edhe pse në shkallë të vogël.

Në përgjithësi, viti 2023 ishte një vit me rritje të kërkesave për azil, sidomos nga Afganistani dhe Siria, ndërsa viti 2024 tregoi një ulje të përgjithshme të numrit të azilkërkuesve dhe një ndryshim të përbërjes së tyre. Ky trend reflekton dinamikat e situatave politike dhe humanitare në vendet e origjinës, si dhe faktorë të ndryshëm që ndikojnë në lëvizjet migratore drejt Shqipërisë.

Tabela 9.2.1: Të huaj azilkërkues, sipas shtetësisë për vitet 2022–2024

Vendi origjinës	Azilkërkues	Azilkërkues	Azilkërkues
	2022	2023	2024
Siri	5	38	17
Irak	18	25	8
Afganistan	36	161	33

Marok	2	0	0
Iran	6	5	6
Algjeri	3	0	1
Pakistan	7	0	13
Serbi	2	0	0
Egjipt	0	2	0
Tunizi	3	0	0
Ukrainë	27	6	7
Jemen	0	5	0
Nepal	0	1	0
Turqi	1	0	1
Bangladesh	3	0	0
Somali	1	16	0
SHBA	1	0	0
Mbretëri e Bashkuar	0	1	0
Rusi	10	0	2
Argjentinë	-	-	2
Kamboxhia	-	-	1
Armeni	-	-	2
Sudan	-	-	1
Arabi Saudite	-	-	1
Kamerun	-	-	2
Kazakistan	-	-	5
Nigeri	-	-	2
Total	125	261	104

Burimi: Ministria e Brendshme.

Gjatë viteve 2023 dhe 2024, Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët ka marrë në total 33 vendime në vitin 2023 dhe 45 vendime në vitin 2024, duke shënuar një rritje prej rreth 36% në aktivitetin e tyre në vitin e fundit.

Në vitin 2023, nuk pati asnjë rast ku u dha statusi i refugjatit, ndërsa në vitin 2024 u miratua një rast i tillë. Statusi i mbrojtjes plotësuese, që është një formë alternative e mbrojtjes, u dha në 14 raste në vitin 2023 dhe u rrit në 16 raste në vitin 2024.

Sa i përket vendimeve negative, numri i refuzimeve ishte i ulët në të dy vitet, me 2 raste në 2023 dhe 3 në 2024, që tregon një përqindje relativisht të vogël të kërkesave të refuzuara. Nuk pati asnjë revokim të statusit në asnjërin vit, por në 2024 u regjistruan 6 raste ku humbja e statusit të refugjatit u bë fakt, një aspekt i ri dhe i rëndësishëm që nuk ishte i pranishëm në vitin e mëparshëm.

Ndërprerjet e procedurave ishin zero në vitin 2023, por u rritën në 9 raste në 2024, duke treguar një ndryshim në trajtimin e kërkesave gjatë këtij viti. Në të njëjtën kohë, pushimet e çështjeve ishin të ngjashme për të dy vitet, me 12 në 2023 dhe 10 në 2024, duke reflektuar një konsistencë në mënyrën se si trajtohen disa çështje për shkak të mungesës së kushteve për vazhdim.

Në vitin 2023 u regjistruan, gjithashtu, 5 pezullime, ndërsa për vitin 2024 nuk raportohet ky tregues, që mund të nënkuptojë ndryshime në proceset administrative ose mungesën e nevojës për pezullime.

Në përmbledhje, vitet 2023 dhe 2024 tregojnë një intensifikim të përgjithshëm të vendimmarrjes nga Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët, me ndryshime në llojet e vendimeve dhe shfaqjen e fenomeneve të reja si humbja e statusit të refugjatit dhe ndërprerjet e procedurave, që reflektojnë dinamikat e sfidave dhe situatave në fushën e azilit në Shqipëri.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhëna mbi vendimet e dhëna nga Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët.

Tabela 9.2.2: Vendimet e dhëna nga Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët (2023–2024)

Vendime	Viti 2023	Viti 2024
Status Refugjati	0	1
Status Mbrojtje Plotësuese	14	16
Refuzime	2	3
Revokime	0	0
Ndërprerje	0	9
Pushime	12	10
Pezullime	5	-
Humbje e Statusit të Refugjatit	0	6
Total	33	45

Burimi: Drejtoria e Politikave të Migracionit, Azilit dhe Antitrafikut, Ministria e Brendshme.

INSTITUCIONE KONTRIBUUESE:

MINISTRIA E BRENDSHME

Drejtoria e Politikave të Migracionit, Azilit dhe Antitrafikut

Drejtoria e Politikave të Shtetësisë

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHETËTIT:

Departamenti për Kufirin dhe Migracionin

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA)

MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Drejtoria e Çështjeve Konsullore

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Drejtoria e Politikave të Përkujdesjes Sociale dhe Shërbimeve Sociale të Integruara

INSTITUTI I STATISTIKAVE (INSTAT)

Tiranë, 2025